

UNIVERSITETI I EJL

УНИВЕРЗИТЕТ НА ЈИЕ

UNIVERSITY OF SEE



FAKULTETI I SHKENCAVE DHE TEKNOLOGJIVE BASHKËKOHORE

ФАКУЛТЕТ ЗА СОВРЕМЕНИ НАУКИ И ТЕХНОЛОГИИ

FACULTY OF CONTEMPORARY SCIENCES AND TECHNOLOGIES

Studimet postdiplomike – cikli i dytë

TEZA

GJITHPËRFSHIRJA E NXËNËSVE ME SINDROMËN DAUN NË SHKOLLA DUKE PËRDORUR
TIK-un NË PROCESIN MËSIMOR

MENTORI,
Prof. Dr. Bujar Rufi

STUDENTI,
Armend Hoti

Tetovë, 2021

Abstract

Nowadays we live in times when the use of information technology has become essential in almost every area and by all age groups, one of the areas which benefits greatly from the technological development is the field of education which uses many alternatives that are offered for use in teaching. As part of information technology, today there are various platforms for teaching or learning where the use of them is increasing day by day.

Not much has been said about the education and inclusion of children with Down syndrome. The purpose of this research is to draw conclusions about the current situation, how much these children are involved in education and how much these children use the technology for learning.

This research will mainly include those schools, in which students with Down syndrome attend and there are eight primary schools. Whereas in the secondary schools in Skënderaj there are no students with Down syndrome.

We will conduct surveys using the method of completing questionnaires by the parents of students with Down syndrome, teachers who have students with Down syndrome in their class. Also, to the teachers whose classes that are dedicated to children with special needs but they have children with the syndrome Down.

A total of 32 people were involved in obtaining information for this study, of which 20 teachers and 12 parents. Data collection was performed through a combined methodology, quantitative and qualitative.

Finally, at the end of this study it was noted that although there are positive approaches to this process, the comprehensive model of students with Down syndrome in public schools is not fully realized. Shortcomings in schools' organization, support infrastructure, information on the use of ICT, adaptation of curricula for students with Down syndrome (curricula for students with special needs) in the implementation of ICT is one of the main problems, and the minimal use of ICT by teachers. The results of this research clearly present how much ICT is used by students with Down syndrome and teachers who work with this group of students in the municipality of Skënderaj.

Abstrakti

Përdorimi i teknologjisë së informacionit kohëve të fundit është bërë i domosdoshëm pothuajse në të gjitha fushat dhe nga të gjitha grupmoshat, njëra ndër fushat e cila përfiton shumë nga ky zhvillim i teknologjisë është edhe fusha e arsimit e cila shfrytëzon alternativa të shumta që ofrohen për t'u përdorur në mësim. Si pjesë e teknologjisë së informacionit, sot janë edhe platformat e ndryshme për mësimdhënie apo mësimnxënie ku përdorimi i të cilave po rritet dita-ditës.

Për edukimin dhe gjithëpërfshirjen e fëmijëve me sindromën Daun nuk është folur shumë. Qëllimi i këtij hulumtimi është që të nxjerrim konkluzione se si është gjendja e tanishme, sa janë këta fëmijë të përfshirë në arsim dhe sa i përdorin këta fëmijë mjetet e teknologjisë në mësimnxënie.

Në këtë hulumtim do të përfshihen kryesisht ato shkolla në të cilat vijojnë mësimin nxënësit me sindromën Daun dhe të tilla janë të të shkolla fillore, kurse në shkollat e mesme në Skënderaj nuk është i përfshirë asnjë nxënës me sindromën Daun.

Do të nxjerrim sondazhe duke përdorur mënyrën e plotësimit të pyetësorëve nga prindërit e nxënësve me sindromën Daun, nga mësimdhënës të cilët në klasën e tyre kanë nxënës me sindromën Daun, si dhe mësimdhënës të cilët në klasët e dedikuara për fëmijët me nevojata veçanta kanë fëmijë me sindromën Daun.

Për marrjen e informacioneve në këtë studim janë përfshirë gjithsej 32 persona, prej tyre 20 mësimdhënës dhe 12 prindër. Mbledhja e të dhënave u realizua përmes një metodologjie të kombinuar, sasiore dhe cilësore.

Në përfundim të studimit është vërejtur se megjithëse ka qasje pozitive të akterëve ndaj këtij procesi, modeli i gjithëpërfshirjes së nxënësve me sindromën Daun në shkollat e rregullta nuk realizohet i plotë. Mangësitë në organizimin e shkollës, si dhe në infrastrukturën mbështetëse, informimi mbi përdorimin e TIK-ut, përshtatja dhe kurrikula për nxënësit me sindromën Daun (kurrikula për nxënës me nevojat veçanta) në zbatimin e TIK-ut është njëra ndër problemet kryesore, e cila nuk i kushtëzon mësimdhënësit ta përdorin TIK-un me nxënësit me sindromën Daun. Rezultatet e këtij hulumtimi paraqesin qartë se sa përdorin e TIK-ut nxënësit e me sindromën Daun dhe mësimdhënësit që punojnë me këtë grup të nxënësve në komunën e Skënderajt.

Tabela e përmbajtjes

Abstract.....	2
Abstrakti.....	3
Lista e figurave	7
Lista e tabelave	7
Lista e grafeve.....	7
LISTA E SHKURTESAVE.....	9
Hyrje.....	10
KAPITULLI I	11
Motivimi.....	11
Qëllimet e hulumtimit.....	12
Hipotezat.....	12
KAPITULLI II.....	13
ZHVILLIMI HISTORIK MBI KUJDESIN E EDUKIMIT	13
2.1 Historiku i edukimit të nxënësve me nevoja të veçanta në vende të ndryshme.....	13
2.2 Historiku i arsimit të fëmijëve me nevoja të veçanta në Kosovë.....	14
2.4 Pedagogjia speciale	16
2.5 Psikologjia	17
2.6 Sociologjia	18
2.7 Llojet e aftësive të kufizuara	19
2.8 Gjithëpërfshirja në arsim si e drejtë e njeriut.....	19
2.9 Të drjetat e arsimit gjithëpërfshirës në Kosovë	21
KAPITULLI III	25
EDUKIMI INKLUZIV	25
3.1 Integrimi i fëmijëve me nevoja të veçanta	25
3.2 Shkolla e hapur për të gjithë	27
3.3 Sigurimi i arsimit cilësor për çdo nxënës.....	27
3.4 Sigurimi i mirëqënies sociale, emocionale dhe shëndetësore të nxënësve	28
3.5 Angazhimi dhe zhvillimi i komunitetit	2928
KAPITULLI IV.....	30
4.1 Njohuritë rreth sindromës Daun.....	30
4.2 Çka është sindroma Daun	30
4.3 Tipet e sindromës Daun	3130
4.4 Mitet dhe faktet për fëmijët me sindromën Daun	33
4.5 Rreth sindromës Daun në Kosovë	3534

4.6 Përkrahja e përfshirjes së nxënësve me sindromën Daun në shkolla të rregullta.....	36
4.7 Shqetësimet mjekësore që munda t'i kenë nxënësit apo fëmijët me sindromën Daun	37
4.8 Njohuritë e mësimdhënësve që duhet t'i kenë në lidhje me nxënësit me sindromën Daun	4039
4.9 Nxënësit me Sindromën Daun në shkolla apo në klasat tuaja dhe sjelljet pozitive ndaj tyre	4140
4.9 Përparësitë e TIK-ut për nxënësit me sindromën Daun	4241
4.10 Aplikacionet apo softuerët e dedikuara për nxënësit me sindromën Daun.....	4443
KAPITULLI V	48
5 Rast studimi - Komuna e Skënderajt.....	48
5.1 Qyteti i Skënderajt dhe popullsia e tij.....	48
5.2 Sistemi edukativo-arsimor në komunën e Skënderajt	48
5.3 Institucioni parashkollor “Nëna Zahide” - Skënderaj	49
5.4 Gjithëpërfshirja e nxënësve me sindromën Daun në shkollat fillore në Skënderaj.....	50
5.5 Shkolla fillore “Abedin Rexha”	50
5.6 Shkolla fillore “Malush Ahmeti”	51
5.7 Shkolla fillore “Ahmet Delija” dhe shkolla fillore “Shaban Jashari”	51
5.8 Shkolla fillore “Ismet Uka” Ticë	51
5.9 Shkolla fillore “Enver Haliti” Lubovec.....	51
5.9 Shkolla fillore “Dëshmorët e Qyqavicës” Çirez	51
5.10 Gjithëpërfshirja e nxënësve me sindromën Daun në shkollat e mesme në Skënderaj	52
5.11 Transporti për fëmijët me sindromën Daun në komunën e Skënderajt	53
KAPITULLI VI	54
6.1 Metodologjia	54
6.2 Popullacioni dhe mostra.....	55
6.3 Procedura për realizimin e hulumtimit.....	55
6.4 Analiza e të dhënave	56
6.5 Etika e studimit	56
6.6 Pyetësi.....	57
KAPITULLI VII	58
ANALIZA, PARAQITJA DHE INTERPRETIMI I REZULTATEVE TË HULUMTIMIT.....	58
7.1 Analiza e të dhënave nga pyetësi.....	58
7.2 Rezultatet nga pjesa e parë e pyetësit	59
7.3 Përvoja e mësimdhënësve kur kanë hasur për herë të parë me nxënës me sindromën Daun	61
7.4 A janë të diskriminuar fëmijët me sindromën Daun në ambientet e shkollës sipas mësimdhënësve	61
7.5 Si pranojnë nxënësit me sindromën Daun nga nxënësit e tjerë në klasë apo në shkollë	62
7.6 Shoqërimi nxënësve të tjerë me nxënësit me sindromën Daun.....	6362
7.7 A janë nxënësit me sindromën Daun agresivë apo kanë pasur konflikt me nxënësit e tjerë.....	63

7.8 Vështirësi që janë hasur në mësimdhënie tek nxënësit me sindromën Daun	64
7.9 A parasheh kurrikula që të përdoret TIK-u në procesin mësimor për fëmijët me sindromën Daun	6564
7.10 A posedojnë shkollat kabinet të TIK-ut ku zhvillohet mësimi me nxënës me sindromën Daun	65
7.11 Sa përdoret TIK-u për mësimdhënie nga mësimdhënësit me nxënës me sindromën Daun?	66
7.12 Pajisjet teknologjike që përdorin mësimdhënësit më së shpeshti	6766
7.13 Përqendrim i nxënësve me sindromën Daun kur kanë përdorur TIK-un në mësimnxënie	67
7.14 A përdoret TIK-u nga nxënësit me sindromën Daun për mësimnxënie.....	68
7.15 Rezultatet nga pyetësi për prindërit e nxënësve (fëmijëve) me sindromën Daun.....	69
7.16 Përdorimi i pajisjeve teknologjike nga fëmijët me sindromën Daun.....	7473
7.17 Fillimi i moshës kur një fëmijë nis ta përdor pajisjen teknologjike si pas prindërve.....	7574
7.18 Sa shpesh i përdor pajisjet e mëposhtme teknologjike fëmija juaj	77
7.19 Kush operon me pajisjet teknologjike ndërsa ato janë në përdorim nga fëmija juaj.....	7978
7.20 Sa i përdorin fëmijët me sindromën Daun mediat sociale	80
7.21 Mediat sociale më të preferuara që përdorin fëmijët me sindromën Daun	81
Përfundim	82
Rekomandimet.....	84
Bibliografia	85
Pjesa shtesë.....	87

Lista e figurave

Figura 1. Ndarja normale e qelizave	31
Figura 2. Trisomia (ndarja jo qelizore e qelizave)	3231
Figura 3. Ndarja e qelizave mozaicizmi	32
Figura 4. Dukja e Special Words	45
Figura 5. Dukja e InnerVoice	46
Figura 6. Dukja e CommunicoTool 2	47

Lista e tabelave

Tabela 1. Përfshirja e nxënësve me sindromën Daun në shkollat e Skënderajt	52
Tabela 2. Përgjigjet me frekuencë më të lart/ nëngrupi i përgjigjeve	60

Lista e grafeve

Graf. 1. Pjesëmarrësit në hulumtim	58
Graf. 2. Grupimet e mësimdhënësve pjesëmarrësve në hulumtim	59
Graf. 3. Përvoja e mësimdhënësve me nxënësit me sindromën Daun	61
Graf. 4. Diskriminim i fëmijëve me sindromën Daun në ambientet e shkollës sipas mësimdhënësve	62
Graf. 5. A pranohen nxënësit me SD nga nxënësit e tjerë në shkollë	62
Graf. 6. Shoqërimi i nxënësve të tjerë me nxënësit me sindromën Daun?	63
Graf. 7. A janë nxënësit me sindromën Daun agresivë apo kanë pasur konflikt me nxënësit e tjerë?	64
Graf. 8. Paraqitja e vështirësive që kanë hasur mësimdhënësit, në mësimdhënie tek nxënësit me sindromën Daun	64
Graf. 9. Si e parasheh kurrikula që të përdoret TIK-u në procesin mësimor për fëmijët me sindromën Daun	65
Graf. 10. A janë të paisur shkollat me kabinet të TIK-ut në klasë që ka nxënës me sindromën Daun	6665
Graf. 11. Përdorni TIK-ut për mësimdhënie me nxënës me sindromën Daun	66
Graf. 12. Pajisja teknologjike që përdorni mësimdhënësit më shpesh?	6766
Graf. 13. Përqëndrimi i nxënësve me sindromën Daun në përdorimin e TIK-ut	67
Graf. 14. Njohuritë rreth softuerëve për nxënësit me sindromën Daun	6867
Graf. 15. Përdorimi i TIK-ut për mësimnxënie nga nxënësit me sindromën Daun	68
Graf. 16. Softueri që përdorin nxënësit me sindromën Daun	6968
Graf. 17. Forma e mësimi që ndjekin fëmijët me sindromën Daun	69
Graf. 18. Grupmoshat e përfshira në hulumtim	7069
Graf. 19. Sfidat e regjistrimit të fëmijëve në shkollë	70
Graf. 20. Ofrimi i shërbimeve ndaj fëmijëve me sindromën Daun	7170
Graf. 21. Mendimet e prindërve ndaj sjelljeve e të tjerëve ndaj fëmijëve të tyre	71
Graf. 22. Ndryshimet shoqërore për të mirën e fëmijëve me sindromën Daun	7271
Graf. 23. Mënyra e ndjekjes së mësimi	7372
Graf. 24. Vështirësitë e dërgimit në shkollë	73
Graf. 25. A përdorin fëmijët me sindromën Daun pajisjet teknologjike	7473
Graf. 26. Arsytet e mospërdorimit të pajisjes teknologjike	74
Graf. 27. Koha e qëndrimit pranë një pajisje teknologjike (p.sh telefona, tableta, kompjuterë)	7574
Graf. 28. Mosha e përdorimit të pajisjeve teknologjike	75
Graf. 29. Nga kush marrin udhëzime fëmijët me sindromën Daun mbi përdorimin e pajisjeve të teknologjisë	7675
Graf. 30. Arsyeja e përdorimit të pajisjeve të teknologjisë	76
Graf. 31. A e përdorni TIK-un për mësimnxënie, për detyra të ndryshme që i jepen nga mësimdhënësit	7776
Graf. 32. A keni njohuri që ekzistojnë softuerë specialë për fëmijët me sindromën Daun për mësimnxënie	77

Graf. 33. Sa shpesh përdoren pajisjet teknologjike nga fëmija juaj? (orë / ditë)	7877
Graf. 34. Arsyet e përdorimit të pajisjeve teknologjike	78
Graf. 35. Operimi me pajisjet teknologjike nga ana e fëmijëve	79
Graf. 36. A e kufizoni aktualisht përdorimin e teknologjisë së fëmijëve tuaj (fëmija me sindromën Daun dhe vëllezërit e motrat e tij ose të saj në zhvillim tipik)	8079
Graf. 37. Kufizimet që bëhen nga ana e prindërve për fëmijët e tyre	80
Graf. 38. Përdorimi i mediave sociale të fëmijëve me sindromën Daun	8180
Graf. 39. Përdorimi i mediave sociale nga ana e fëmijëve me sindromën Daun	81

LISTA E SHKURTESAVE

FSDEK-u Përkrahjes për zhvillimin e sektorit të arsimit në Kosovë, i financuar nga Ministria e Punëve të Jashtme e Finlandës

DAK - Departamenti i Arsimit të Kosovës

UNICEF - Fondi i Kombeve të Bashkuara i Fëmijëve

MASHT - Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë

OECD - Organizata për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim

AAMD - Asociacioni amerikan për retardim mental

PSAK - Plani strategjik për Arsimin e Kosovës

PIA - Plani Individual i Arsimit

N.V – Nevoja të veçanta

DKA - Drejtoria Komunale e Arsimit

OPFAKKOS - Organizata e prindërve të fëmijëve me aftësi të kufizuara e Kosovës

Hyrje

Fëmijët me sindromën Daun (Down) në Kosovë mund të themi lirisht që janë shtresa më e ndjeshme e shoqërisë ku fatkeqësisht ende vuajnë nga forma të ndryshme të diskriminimit, pavarësisht nga legjislacioni ekzistues, ata shpesh nuk kanë mbështetjen sociale të plotë të integritit të tyre në shoqëri.

Ky diskriminim vlen edhe për sistemin e arsimit, ku profesionistët dhe administratorët nuk janë gjithmonë të sigurt se si të garantojnë të drejtën e fëmijëve me sindromën Daun për një arsim më të mirë dhe si të kujdesen për nevojat e tyre me sukses dhe efikasitet. Ndërsa kur bëhet fjalë për përdorimin i TIK-ut në mësimdhënie dhe mësimnxënie me nxënës të me sindromën Daun mund të themi që mësimdhënësit nuk shfaqin aspak kujdes në këtë aspekt për këtë kategori që është lënë anash edhe nga pikëpamja e hartimit të kurrikulës për këtë kategori. Fatkeqësisht kjo kategori diskriminohet edhe nga institucionet përgjegjëse.

Teknologjia është bërë pjesë e jetës moderne përmes së cilës sigurohet mbështetje në mësimdhënie, e në mësimnxënie si dhe në komunikimet e ndryshme sociale ndërmjet nxënësve. Kjo formë e re e komunikimit mundëson që transferimi i tekstit, fotografive, audiove, videove, apo informacionit në përgjithësi të bëhet gjithnjë e më shumë efikasitet midis nxënësve gjë që do të ishte një avancim shumë i madh nëse edhe fëmijët me sindromën Daun do ta përdorin teknologjinë si bashkëmoshatarët e tyre, pasi që mësimi dhe të kuptuari përmes pamjeve vizuale është njëra ndër pikat shumë të forta tek fëmijët me sindromën Daun.

Pavarësisht që prindërit e këtyre fëmijëve bëjnë përpjekje që fëmijët e tyre të kenë më shumë qasje në pajisjet teknologjike akoma mungon një gatishmëri që këta fëmijë të përdorin TIK-un në procesin mësimor në nivelin e bashkëmoshatarëve të tyre.

Si rezultat i gjithë kësaj situatë lindi ideja të bëhet një hulumtim i cili e pasqyron gjendjen reale në komunën e Skënderajt. Pra hulumtimi është nisur me qëllimin për të grumbulluar informacione të qarta dhe të sakta për këtë fushë.

KAPITULLI I

Motivimi

Përdorimi i teknologjisë (TIK-ut) në procesin mësimor është bërë pothuajse pjesë e pandashme, ku shumë nxënës dhe mësimdhënës i shfrytëzojnë pajisjet e teknologjisë për mësimnxënie dhe mësimdhënie. Pajisjet teknologjike tashmë janë bërë pjesë e përditshmërisë dhe zënë një pjesë të madhe të kohës për shumë njerëz, duke përfshirë fëmijët dhe adoleshentët. Përdorimi i TIK-ut ka potencial të madh për zhvillimin dhe fuqizimin e fëmijëve dhe të rinjve, si dhe për t'i ndihmuar ata në përmbushjen e nevojave të tyre për informim dhe komunikim si dhe në arritjen e rezultateve sa më të mira në mësimnxënie. Efektet pozitive të përdorimit të TIK-ut veçse dihen, por nxënësit (adoleshentët) duhet të vetëdijesohen edhe për rreziqet ndaj të cilave janë të ekspozuar kur përdorin TIK-un. Për të qenë në gjendje që nxënësit të shfrytëzojnë TIK-un për të mirën e tyre, ata duhet të mësojnë disa rregulla të nevojshme për të qenë të mbrojtur.

Media sociale i referohet një sërë mjetesh dhe shërbimesh të bazuara në ueb faqe që përdoren për një gamë të gjerë aplikimesh. Rrjetet sociale kanë një potencial të madh në arsimin e të rinjve. Shumë njerëz e përceptojnë TIK-un si burim të informatave të përditësuara për botën, ndërsa për disa është mjet për komunikimi, vetëpromovim dhe lëvdatë për arritjet e dikujt. Rritja e përdorimit të TIK-ut ka një interes të përgjithshëm në pedagogji dhe në mësimdhënie. Një potencial i tillë mund të përdoret në mënyrë efektive në arsim, në mënyrë specifike për të përshkruar mjetet më të njohura të TIK-ut dhe për të ofruar një pasqyrë mbi përfitimet dhe rreziqet kryesore të zbatimit të këtyre mjeteve dhe shërbimeve në procesin e të nxënësve nëpër shkollave.

Profesionistët e fushës së edukimit në vazhdimësi synojnë që teknologjia të jetë pjesë e pandashme në strategjitë moderne të edukimit. Me avancimin e madh të fushës së teknologjisë është shumë e rëndësishme të kuptojmë se si inovacionet në teknologji kanë ndikim në fushën e edukimit.

Përdorimi i teknologjisë informative bashkë me faktorë të tjerë kanë ndikim të madh në qëllimet apo objektivat në mbështetje të procesit të të mësuarit dhe ngritjen e kualitetit të edukimit. Sidomos kur kemi të bëjmë me një kategori e cila është mjaft e ndjeshme në shoqërinë tonë, e sidomos në mjediset shkollore që mos të jenë edhe kjo kategori pjesë e epokës së teknologjisë informative

Qëllimet e hulumtimit

Qëllimi i këtij hulumtimi është që të nxjerrim konkluzione rreth gjendjes së tanishme, sa janë këta fëmijë të përfshirë në arsim dhe sa është krijuar një shkollë e hapur dhe inkluzive për të gjithë pa dallim diferencimsh.

Ky hulumtim do të mundësojë këndvështrime të reja për faktorët ndikues në çështjet e caktuara që lidhen me gjithëpërfshirjen e fëmijëve me sindromën Daun në shkollat e rregullta. Gjithashtu ky hulumtim qartëson aspektet e paqarta që kanë të bëjnë me akterët e ndryshëm të përfshirë në procesin e gjithëpërfshirës. E ndihmon atë të krijojë lidhje të drejtpërdrejta me akterët që janë pjesë e procesit, pra gjithëpërfshirjen e fëmijëve me sindromën Daun në një kontekst të caktuar gjeografik, kulturor dhe social ku zhvillohet.

Gjithashtu konsiderojmë se ky hulumtim do të ndihmojë që të intervenohet nga institucionet gjegjëse, me qëllim të përmirësimit të kushteve të këtyre fëmijëve që të kenë të paktën një kabinet të Informatikës.

Gjatë realizimit të këtij hulumtimi janë paraparë këto qëllime:

1. Grumbullimin e informacioneve për gjithëpërfshirjen e fëmijëve me sindromën Daun në shkollat e Skënderajt;
2. Të identifikohen faktorët pozitivë ose pengues në procesin gjithëpërfshirës;
3. Të vlerësohet procesi i zbatimit në praktikë të modelit gjithëpërfshirës të fëmijëve me sindromën Daun në klasa të rregullta, në shkollat e komunës së Skënderajt;
4. Ofrimin e një hulumtimi cilësor, studiuesve që interesohen për fushën e nxënësve me sindromën Daun në përgjithësi;
5. Avokimi i problemit të institucionet gjegjëse.
6. Motivimin dhe inkurajimin që personat me sindromën Down dhe familjarët e tyre të vetëdijesohen që sa më shumë ta përdorin TIK-un.

Hipotezat

Në kuadër të punimit të magjistraturës, konform realizimit të hulumtimit do të jenë të adresuara hipotezat vijuese:

1. Nxënësit me sindromën Down nuk përdorin TIK-un për mësimnxënie.
2. Mësimdhënësit që punojnë me këtë kategori nxënësish nuk përdorin TIK-un për mësimdhënie.
3. Prindërit e nxënësve me sindromën Down nuk u kushtojnë kujdes fëmijëve që të përdorin TIK-un.

4. Kurrikula për nxënës me sindromën Daun nuk e parasheh përdorimin e TIK-ut për këta nxënës në procesin mësimor.

KAPITULLI II

ZHVILLIMI HISTORIK MBI KUJDESIN E EDUKIMIT

2.1 Historiku i edukimit të nxënësve me nevoja të veçanta në vende të ndryshme

Historia na tregon se kujdesi për personat me vonesë mentale ka filluar në gjysmën e shekullit XIX edhe pse sëmundjet kanë ekzistuar me ekzistimin e vetë njeriut.

Para shekullit XIX, as që është menduar rreth edukimit të personave me vonesë mentale, në të kundërtën, janë sjellë në mënyrë më arrogante dhe i kanë mbytur, sepse këta persona i kanë konsideruar si sëmundje të shoqërisë. Në kohën e vjetër personat me vonesë mentale i kanë mbytur dhe i kanë hedhur nëpër gropa.

Indianët (Bejtullahu, 2007) këta fëmijë i kanë hedhur jashtë qytetit dhe i kanë mbytur. Romakët, me pëlqimin e fqinjëve, fëmijët me të meta në zhvillim, i kanë hedhur në lumin Tibër.

Eliminimi i fëmijëve me vonesë mentale është motivuar për shkak të religjionit, çështjeve mentale, si dhe çështjeve ekonomike për nevojat e ushtrisë për ushtarë të aftë. Në Spartë secili person është dashur të bëhet ushtar, kështu që për t'u bërë ushtar ka qënë dashur të jetë shpirtërisht dhe fizikisht i shëndoshë dhe i fortë.

Luteri ka thënë se fëmijët jonormalë i janë nënshtruar dreqit, për atë Zoti i ka dënuar (Education, Governor's Council on Disabilities and Special).

Në atë kohë të paaftit sterilizoheshin, me qëllim që të mos vinin deri të lindja e fëmijëve.

Sterilizimi edhe sot përdoret në disa shtete siç është rasti të ata prindër që lindin fëmijë me epilepsi, me skizofreni dhe në raste të trashëgimisë që paraqesin invaliditet të rëndë si dhe alkoolistët.

Pra nëse bazohemi në thëniet e këtyre dy mendimtarëve, fëmijët me probleme mendore duhen eliminuar nga shoqëria që në lindje dhe se këta nuk kanë të drejtë ta gëzojnë jetën e tyre. Sipas këtyre shkencëtarëve njerëzit me prapambetje mendore nuk mund të kontribuojnë asgjë për shoqërinë.

Mbytja e njerëzve të pavlefshëm nuk ka arsyetim të asnjë qytetar. Në bazë sociale të paaftit nuk mund të mbeten si jo produktivë të shoqërisë, atëherë bota kishtë për t'u ndarë në atë produktivë dhe

joproductivë, me këtë bota kishtë për t'u ndarë në dy klasa apo taborre, përmbytja do të merrte përmasa të gjëra. Shikuar nga aspekti biologjik i popullsisë, mbytja e këtyre fëmijëve, është e paarsyeshme sepse me mbytjen e këtyre fëmijëve nuk i asgjëson shkaqet e dobësisë mentale (Bejtullahu, 2007).

Edukimi i fëmijëve me vonesë mentale të lehta ka filluar me vonesë, në gjysmën e shekullit XIX. Vonesa e edukimit ka qënë shkas sepse çrregullimet dhe të metat e këtyre fëmijëve me vështirësi janë dalluar dhe me vonesë janë zbuluar, kështu që edukimi dhe arsimimi i këtyre fëmijëve me vonesë ka filluar, edhe ajo në bazë të diferencimit të tyre.

2.2 Historiku i arsimit të fëmijëve me nevoja të veçanta në Kosovë

Arsimi Special në Kosovë, ka filluar të zbatohet në gjysmën e dytë të shek. XX, ky lloj arsimimi kishte karakter konviktor dhe numri i fëmijëve të përfshirë në të ishte tejet i vogël. Ky lloj arsimi special ishte i përqendruar në qytetet më të mëdha në Kosovë, ndërsa në komunat më të vogla nuk organizohej fare.

Shkollat speciale – Qendrat Burimore në Kosovë

- “Xheladin Deda”, në Pejë (dëmtime në të parë)
- “Lef Nosi”, në Prizren (dëmtime intelektuale)
- “Nënë Tëreza”, në Prizren (dëmtime në të dëgjuar)
- “Përparimi”, në Prishtinë (dëmtime intelektuale)
- “Nënë Tëreza”, në Mitrovicë (dëmtime intelektuale)¹

Ekziston një shkollë speciale në veriun e Mitrovicës, ku vijojnë mësimet fëmijët serbë, e cila nuk ishte deri para një viti të integruar në sistemin arsimor të Kosovës dhe të MASHT-it megjithëse ky integrim ende nuk na ofron informata të mjaftueshme për të.

Me nismën e Departamentit të Arsimit të Kosovës DAK-it dhe mbështetjen e FSDEK-ut, procesi i transformimit nga shkollat speciale në qendra Burimore, në Kosovë filloi nga viti 2001 duke vazhduar se implemtuari përmes një udhëzimi administrativ në vitin 2005.

Shkaqet për ndryshime nga shkollat speciale në qendra burimore është ngase sistemi i arsimit special në Kosovë funksionoi në kushtet e okupimit për 10 vite me radhë, problemet me të cilat ballafaqoheshin shkollat speciale gjatë kësaj periudhe ndikuan negativisht në organizimin e punës pedagogjike.

- Shumë nxënës me nevoja të veçanta të pa përfshirë në procesin mësimor e sidomos në zonat rurale;

¹Shyti. H. & Osmani. “V., *Trajnime për mësimdhënës*” Shkolla “Nënë Tëreza” në Mitrovicë, 2015

- Mungesa e kurrikulave bashkëkohore;
- Mungesa e tekstëve dhe pajisjeve shkollore;
- Mungesa e burimeve njerëzore – materiale;
- Mungesa e një kornize ligjore për arsimin e fëmijëve me nevoja të veçanta;
- Mungesa e kuadrove profesionale;
- Mungesa e informatave për fëmijët jashtë sistemit arsimor;
- Niveli i ulët i vetëdijesimit për edukimin e fëmijëve me nevoja të veçanta;
- Mungesa e hapësirave shkollore;
- Mungesa e PIA-së të modifikuar për fëmijët me nevoja të veçanta;
- Fëmijët me nevoja të veçanta identifikoheshin si njerëz të institucioneve speciale.
- Prandaj UNICEF-i në Kosovë bën referencë eksplicite të fëmijët me nevojatë veçanta si ata që janë të rrezikuar më së shumti nga përjashtimi nga procesi arsimor sepse strukturat dhe sistemi nuk përmbushin nevojat e tyre, do të thotë fëmijët me paaftësi të mëdha, ata të komunitetit rom, ashkali, dhe egjiptian, ata që jetojnë në varfëri të skajshme, ata që duhet të udhëtojnë në distanca të mëdha për të shkuar në shkollë, fëmijët që punojnë dhe ata që kanë paragjykime familjare siç janë vajzat adoleshente.
- Tutje në vitin 2002 u miratua ligji për arsimin e Kosovës: UNMIK/REG/2002/19.
- Së paku në letër, ligji siguronte të drejtat e barabarta të fëmijëve me nevoja të veçanta, por nuk garantonte përfshirjen e plotë të tyre.

Në përgjithësi, viti 2002 ishte shpresëdhënës për arsimin e fëmijëve me nevoja të veçanta. Plani strategjik bënte thirrje për regjistrim të të gjithë fëmijëve në shkollë. Identifikimi, diagnoza, trajtimi dhe arsimimi i fëmijëve me nevoja të veçanta zë vend në strategjinë afatgjate të MASHT-it, që centralizoi përpjekjet e arsimit special, duke planifikuar që të krijojë një qasje të barabartë dhe profesionale për të gjithë dhe gradualisht duke integruar këta fëmijë në arsimin e rregullt dhe në shoqëri (OECD, 2006).² Ai bënte thirrje për legjislacion për arsimin gjithëpërfshirës (i përkufizuar si arsim për të gjithë) për aftësim të mësimdhënësve të arsimit special, ndërhyrje të hershme tek parashkollorët, identifikim, diagnostik dhe hulumtim.

Dokumenti i vitit 2002 (MASHT, 2002) është i pari që përmend strategjinë ekzistuese “përfshirja përmes përjashtimit të përkohshëm”, që do të thotë përfshirja e sa më shumë fëmijëve në sistemin shkollos duke vendosur shumë fëmijë me nevoja të veçanta në “klasat e bashkëngjitura” klasat për fëmijët me nevoja të veçanta në shkollat e rregullta – dhe në shkollat speciale, disa edhe me akomodim

²Unicef & ENGJUJT. Drejtësia e mohuar: *Gjendja e arsimit të fëmijëve me nevoja të veçanta në Kosovën e pasluftës*, 2009.

për fjetje. Shpresohet se fëmijët në klasat e bashkëngjitura së shpejti do të integroheshin plotësisht në klasat e rregullta, dhe fëmijët në shkollat speciale do të zhvendoseshin gradualisht nëpër shkolla. Mësimdhënësit specialë më pas do të bëheshin mësimdhënës shëtitës (udhëtues), në krahasim me mësimdhënësit e klasave të rregullta, dhe ndërtesat e shkollave speciale do të bëheshin qendra të resurseve. Kjo ishte politika zyrtare e MASHT-it.

2.3 Disiplinat të cilat i kontribuojnë studimit të vështirësive në të nxënë

Vështirësitë në të nxënë janë fushë multidisiplinare së cilës i kontribuojnë shumë, disa disiplina (edukimi – pedagogjia speciale, psikologjia, sociologjia, disiplinat gjuhësore dhe mjekësia) (Sahliu, 2009).

2.4 Pedagogjia speciale

Nocioni “special” zakonisht nënkupton diçka të jashtëzakonshme, të veçantë, jo të rëndomtë, d.m.th diçka që dallon nga normat e rëndomta. Pedagogjia speciale si disiplinë shkencore e cila studion ligjësitë e zhvillimit, edukimit dhe arsimit të personave me nevoja të veçanta. Në vendet anglofone përdoret termi “Edukim special” (Special Education) që nënkupton arsimimin e personave të cilët në aspektin fizik, mendor, emocional e social dallojnë nga grupet homogjene të nxënësve që janë të përfshirë në sistemin e rregullt të arsimit e për të cilët nevojiten strategji të përshtatshme të mësimdhënies për t’iu përshtatur nevojave të veçanta të tyre. Në vendet frankofone, përdoren termet “edukim special” (Education speciale) që përfshin aspektet e edukimit shkollor dhe jashtëshkollor të personave me dëmtime të ndryshme.

Në Austri përdoret edhe termi “pedagogji mjekësore” (Heilpädagogik) e cila për një kohë të gjatë ka mbajtur më tepër anën e drejtimit medicinal të trajtimit të personave me nevoja të veçanta por që gradualisht është ndier nevoja për përfshirje më të shumta të aspekteve pedagogjike, psikologjike e sociologjike (Zabeli, Edukimi inkluziv, 2003).

Nga kjo që u theksua më lart kuptojmë se në disa vende “edukimi special” përveç aspekteve edukative brenda shkollës, gjithsesi i kushton vëmendje të veçantë edhe edukimit dhe përkrahjes jashtëshkollore. Në komunitet ka persona me nevoja të veçanta, të cilët e kanë mbaruar shkollën fillore dhe nuk kanë pasur mundësinë për të vazhduar edukimin e mëtutjeshëm.

Nevojat e këtyre personave janë të mëdha dhe gjithsesi u duhet përkrahje nga institucionet përkatëse dhe profesionistë të tjerë.

Detyrat e pedagogjisë speciale janë të shumta dhe të ndryshme, ndër to më të rëndësishme janë: të popullarizojë rëndësinë dhe nevojën e kujdesit dhe ndihmën e këtyre fëmijëve, duke u bazuar nga

shikimi i gjithanshëm vërejmë karakteristikat e këtyre fëmijëve me qëllim të konstatimit të vështirësive që kanë, dhe në bazë të karakteristikave të lartpërmendura, bëjmë klasifikimin adekuat, i cili klasifikim u ndihmon mësuesve dhe profesionistëve të tjerë rreth rehabilitimit të këtyre fëmijëve. Pra merret me metodat e punës më bashkëkohore edukative-arsimore të punës në aftësimin e këtyre fëmijëve deri të bëhen të aftë për vetveten dhe komunitetin.

Nga kjo vërejmë se përveç Pedagogjisë Speciale është shumë e rëndësishme dhe e domosdoshme që për punën me fëmijët me nevoja të veçanta duhet të merret edhe Psikologjia, pasi që nga kjo zbulojmë çrregullimet e personalitetit, gjendjen emocionale, jetësore etj.

2.5 Psikologjia

Psikologjia është shkencë e cila merret me zhvillimin e jetës psikike të fëmijëve dhe të të rriturve, siç merret psikiatria, psikopatologjia me studimin e personave të sëmurë psikik – shpirtëror. Rezultatet e këtyre ndihmojnë në studimin e drejtë dhe të suksesshëm të oligofrenopedagogjisë (e cila nuk merret vetëm me veçoritë e kategorive të këtyre fëmijëve, por është shkencë e cila merret edhe me rehabilitimin e fëmijëve me nevoja të veçanta mendore, gjithashtu merret dhe studion problemet dhe aftësimin e fëmijëve me vonesë psikofizike), ku së pari njoftohemi me gjendjen normale psikike të personit. Së dyti i zbulojmë shkaqet e paraqitjeve psikopatologjike, të cilat shkaktohen të fëmijët gjatë zhvillimit mental. Kështu, me këtë vijnë së shpejti të masat korrektuese. (Emrush, 2007)

Psikologët veçanërisht ata të specializuar në zhvillimin e fëmijës, teorinë e të nxënës, psikologjinë kognitive dhe psikologjinë shkollë, kanë pasur një ndikim të madh në këtë fushë. Psikologët e shkollës posaçërisht kanë pasur një ndikim direkt sepse ata kanë vëzhguar, testuar, vlerësuar dhe karakterizuar sjelljen e fëmijëve. Puna e specialistit për zhvillimin e fëmijës, i cili përqendrohet në proceset zhvillimore të fëmijës normal, është bërë bazë për shumë koncepte të fëmijës atipik. Teoricienët e të nxënës e kanë pasur fushën me analizat e sjelljes së individit, që identifikojnë detyrat që do të mësohen dhe sjelljet që duhet të priten. Teoria e të sjellurit dhe psikologjia kognitive janë një ndër kontributet e teoricientëve të të nxënës drejt hulumtimit të aftësive të kufizuara në të nxënë (Sahliu, 2009).

Me qëllim të identifikimit të drejtë të këtyre problemeve, mësuesit duhet të bashkëpunojnë me prindërit, psikologët dhe mjekët. Posaçërisht vëmendje e veçantë duhet kushtuar vështirësive të ndryshme me të cilat përballen nxënësit gjatë procesit të mësimnxënies, p.sh. vështirësia e përqendrimit, problemet e të mbajturit mend, disleksia etj.

Sipas L. S. Vigotskit “zhvillimi kognitiv të individit sendërtohet përmes ndërveprimit të fëmijës me të rriturit dhe me bashkëmoshatarët më të aftë” (Vygotsky). Kjo nënkupton se fëmija që nga mosha

e hershme duhet të ndërveprojë dhe të bashkëpunojë fillimisht me prindërit, por edhe me anëtarët e tjerë të familjes, prindërit duhet të flasin sa më shumë me fëmijët e tyre, të japin shpjegime fillimisht rreth lodrave e më pas edhe rreth gjërave të tjera më të komplikuara.

Pas kësaj është shumë i rëndësishëm bashkëpunimi me vëllezërit dhe motrat, e posaçërisht bashkëmoshatarët e tjerë, pasi që kjo është një mënyrë e arsyeshme për zhvillimin kognitiv të fëmijës, e posaçërisht socializmin e tij. Në shkollë vërejmë shumë nxënës që nuk kanë ndonjë dëmtim fizik apo mendor, por që ju ka munguar dhe mungon ende ky bashkëpunim. Me këtë mund ta lidhim edhe gjithëpërfshirjen e fëmijëve me nevoja të veçanta në klasë të rregullta, pasi që ata do të përmirësojnë mësimnxënien duke bashkëpunuar me bashkëmoshatarët e tyre më të aftë.

2.6 Sociologjia

Për punën me fëmijë me nevoja të veçanta është e nevojshme edhe shkenca e Sociologjisë. Sociologjia i ndihmon oligofrenopedagogjisë meqë merret me problemet sociale dhe shikon se si faktorët socialë ndikojnë në gjendjen psikofizike të fëmijëve me vonesë në tërësi, veçanërisht duhet shikuar se si ato negativisht mund të ndikojnë në zhvillimin e tyre.³

Është i njohur fakti që çdo disiplinë, pavarësisht objektit të studimit, nuk anashkalon dot rëndësinë e njohjes së dimensionit social. Pasi ndihmon në thellimin mbi njohjen njerëzore, transferimin e kësaj njohjeje në veprimtari praktike shoqërore si dhe mënyrat e ndikimit mbi rezultatet e saj duke i parashikuar ato. Kjo reflekton mbi shumë veprime, dukuri dhe ngjarje të jetës së përditshme, të cilat në tërësinë e tyre përbejnë atë univers shoqëror, pjesë e të cilit janë, jeta, angazhimet, veprimet dhe krijimtaria e çdonjërit prej nesh.

Sociologjia në aspektin shkollor i ndihmon nxënësit të zgjerojnë aftësitë e vlerësimit për dimensionin social të individit dhe të grupit, si edhe sensibilizon ata mbi funksionet që luajnë një sërë institucionesh sociale si: familja, shkolla, media, shoqëria, komuniteti etj., në drejtim të edukimit të tyre. Pra vlen të theksohet se nxënësit me nevoja të veçanta dhe familjarët e tyre, në supet e tyre kanë një barrë të rëndë, si në edukimin e këtyre fëmijëve, ashtu edhe në rrethanat ekonomiko-sociale. Ajo që është më e vështira në shumicën e rasteve, është që këta fëmijë i kanë edhe prindërit e tyre ose disa anëtarë të familjes me nevoja të veçanta, dhe kjo e vështirëson edhe më shumë gjendjen dhe edukimin e tyre. (Në Kosovë ende nuk ka raste që këto familje i ka vizituar ndokush nga organet profesionale për të parë nga afër gjendjen dhe rrjedhjen e këtyre familjeve të cilët kanë fëmijë me nevoja të veçanta).

³ Bejtullahu. Emrush; *“Njohuri mbi aftësinë e kufizuar dhe rehabilitimi”*, Prishtinë, 2007, fq. 19.

Markku Leskinen (në librin Edukimi special në Kosovë) ka cekur se “në Kosovë përkrahja nga të afërmit dhe shokët është vendimtare, sepse sektori zyrtar i përkrahjes nuk është në gjendje të sigurojë përkrahje të mjaftueshme për momentin. Mësuesit duhet t’i inkurajojnë prindërit të ndërtojnë dhe të mbajnë lidhjet familjare, dhe lidhjet e miqësisë kurdo që të jetë e mundur. Gjithëpërfshirja / inkluzioni i vërtetë i familjeve të fëmijëve me dëmtime ndodh në aktivitetet në fqinjësi. Ndihma e rastit është e nevojshme në secilën familje dhe familjet me fëmijët me dëmtime nuk janë të përjashtuar në këtë drejtim. Dhe më e rëndësishme, kontaktet normale sociale/shoqërore tipike në fqinjësi janë thelbësore për fëmijët dhe të gjithë anëtarët e familjes. Ndjenja e përkatësisë dhe e të qenët anëtar janë të rëndësishme në kualitetin e jetës së të gjithë njerëzve”.

2.7 Llojet e aftësive të kufizuara

Në çdo vend të botës, prandaj edhe në shkollat tona, ekzistojnë një numër i konsiderueshëm i nxënësve me ngecje në zhvillimin mendor, të cilët kuptohet se kanë vështirësi në të nxënë të përmbajtjeve mësimore dhe në inkuadrimin e suksesshëm në aktivitetet të ndryshme shkollore e jashtëshkollore.

Kështu flitet për fëmijët me defekte mendore, për ologofrenë, për prapambetjen mendore (retardim mental), për zhvillueshmerin e pamjaftueshme mendore, për zhvillim të vonuar mendor, për ngecjen në zhvillimin mendor. Gjithashtu, si në të folurit e përditshëm edhe në literaturën shkencore ndeshim terma (fyese): idiotë, imbecilë, debilë të cilët shprehin nivele të ndryshme të inteligjencës. Për këtë, në vend të tyre preferojmë të përdoren emërtimet: ngecje e zhvillimit mendor në shkallë të rëndë (në vend të – idiotë), në shkallë të mesme (më vend të – imbecilë) dhe në shkallë të lehtë (në vend të – debilë), (Zabeli, Nxënësit me nevoja të veçanta, 2001)

Lidhur me emërtimin e nxënësve me nevoja të veçanta ka një etikë, në mënyrë që të mos jetë ofenduese. Në Kosovë përdoret termi “nxënës me nevoja të veçanta” dhe kjo akceptohet me lehtë. Gjatë vizitës nëpër shkollat e komunës së Skënderajt vërejtëm se këta nxënës kanë lloje të ndryshme të çrregullimeve, (por që në nuk do t’i klasifikojmë në shkallët e lartpërmendura) ndër to më të shumta ishin: Dëmtime në tru, sindroma Doun, kretinizmi (më shumë hyn në kuadër të dëmtimeve fizike), dëmtime në të folur, dëmtime në të dëgjuar, dëmtime në të pamurit, belbëzim, nxënës me çrregullime në sjellje, çrregullime në të mbajturit në mend, çrregullime psikofizike, epilepsi etj. Kishte të tillë që ishin dëmtuar (në periudhën e foshnjërisë) gjatë luftës së fundit në Kosovë.

2.8 Gjithëpërfshirja në arsim si e drejtë e njeriut

Thelbi i arsimit gjithëpërfshirës është e drejta njerëzore për edukim, e përcaktuar në Deklaratën Universale të Drejtave të Njeriut në vitin 1948, e cila thekson se “çdo njeri ka të drejtë për edukim”. Edukimi duhet të drejtohet për nga zhvillimi i plotë i personalitetit njerëzor dhe fuqizimi i respektimit të drejtave të njeriut dhe lirive themelore.(OKB, 1948, neni 26).

Në Konventën mbi të drejtat e fëmijës, neni 23 thotë:

1. Shtetet Palë pranojnë se fëmijët me paaftësi mendore ose fizike duhet të bëjnë një jetë normale dhe të përshtatshme, në kushte që garantojnë dinjitetin e tij, që nxisin autonominë dhe lehtësojnë pjesëmarrjen e tij aktive në jetën e bashkësisë.
2. Shtetet Palë njohin të drejtën e fëmijës me paaftësi për kujdes të posaçëm dhe nxisin e sigurojnë, brenda mundësive të të ardhurave të disponueshme, dhënien fëmijës i cili përmbush kushtet, si dhe atyre që kujdesen për të, të ndihmës që kërkohet dhe që i përshtatet gjendjes së fëmijës dhe gjendjes financiare të prindërve të tij, ose të atyre që kujdesen për të.
3. Duke njohur nevojat e veçanta të fëmijës me paaftësi, ndihma e dhënë jepet falas sa herë të jetë e mundur, duke pasur parasysh burimet financiare të prindërve të tij ose të atyre që kujdesen për të dhe kjo synon që fëmijët me paaftësi të kenë mundësi efektivisht të marrin arsim, kualifikim, shërbime shëndetësore, shërbime riaftësimi, përgatitje për punësim dhe veprimtari argëtuese, në mënyrë që fëmija të sigurojë një integritet shoqëror dhe zhvillim vetjak sa më të plotë, përfshirë zhvillimin tij kulturor dhe shpirtëror.
4. Shtetet Palë, në frymën e bashkëpunimit ndërkombëtar, nxisin shkëmbimin e informacionit të përshtatshëm në fushën e kujdesit shëndetësor parandalues dhe të trajtimit mjekësor, psikologjik dhe funksional të fëmijëve me paaftësi, përfshirë përhapjen dhe mundësinë e marrjes së informacionit lidhur me metodat e riaftësimit, edukimit dhe shërbimeve të formimit profesional, me qëllim që Shtetet Palë të kenë mundësi të përmirësojnë cilësitë dhe aftësitë e tyre dhe të zgjerojnë përvojë e tyre në këto fusha. Në këtë drejtim, duhet të mbahen parasysh në mënyrë të veçantë nevojat e vendeve në zhvillim.⁴

Gjithashtu, Konventa e UNËSCO-s Kundër Diskriminimit në Edukim (1960), është një dokument tjetër ndërkombëtar i rëndësishëm për të drejtat e njeriut, që thekson ndalimin dhe eliminimin aktiv të diskriminimit. Një rrjedhojë logjike e këtyre të drejtave është se të gjithë fëmijët kanë të drejtë të marrin

⁴Konventa mbi të drejtat e fëmijës, Miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Organizatës së Kombeve të Bashkuara më 20 nëntor 1989.

atë lloj arsimit që nuk i diskriminon ata në asnjë aspekt, duke përfshirë këtu edhe ata me nevojë të veçanta.

Në vitin 2006, Organizata e Kombeve të Bashkuara, miratoi Konventën për të Drejtat e Personave me Nevojë të veçanta. Në nenin 24 të saj thuhet se “shtetet duhet t’u garantojnë personave me nevojë të veçanta të drejtë në arsimin gjithëpërfshirës, ashtu si të gjithë fëmijëve të tjerë në komunitet ku ata jetojnë”. Po në këtë nen përcaktohen detyrimet e shteteve për të siguruar lehtësitë dhe përshtatshmëritë e nevojshme me qëllim gjithëpërfshirjen e fëmijëve me nevojë të veçanta në sistemin arsimor. (OKB, 2006).

Duke u bazuar të këto dokumente ndërkombëtare vërejmë se nxënësve me nevojë të veçania i janë rregulluar disa të drejta të cilat garantojnë qasje në të gjitha sferat e jetës për këta nxënës, duke filluar nga arsimimi i tyre, mirëqenia sociale e punësimi. Konventa mbi të drejtat e fëmijës deklaron se fëmijët me paaftësi mendore ose fizike duhet të kenë qasje në jetën normale, ashtu si të gjithë të tjerët. Edhe këta janë pjesë e kësaj bashkësie dhe duhet ta luajnë rolin e tyre aktiv.

Në shumicën e shteteve këtyre fëmijëve u sigurohet ndihmë e vazhdueshme financiare, po ashtu edhe prindërve apo kujdestarëve të tyre. Duke u bazuar në nevojat e fëmijës me paaftësi, ndihma u jepet falas sa herë të jetë e mundur. Sipas këtyre rregullave duhet krijuar mundësi për marrjen e arsimimit sa më efektiv, pastaj kualifikimin, shërbimin shëndetësor, shërbimin psikologjik, punësimin, etj. Shihet se pikësynim i tërë këtyre deklaratave janë garantimi i të drejtave të njeriut për të gjithë dhe mos diskriminimin e fëmijëve me nevojë të veçanta. Përveç të tjerash këtu ngritet edhe çështja e garantimit të së drejtës së gjithëpërfshirjes së fëmijëve me nevojë të veçanta në arsim. Pikat e lartpërmendura janë pjesë e deklaratave të shumta ndërkombëtare por që në shumicën e shteteve e sidomos në vendet e zhvilluara kanë gjetur edhe zbatim praktik. Në Kosovë disa nga këto vende nuk kanë gjetur zbatimin e duhur në praktikë.

2.9 Të drejtat e arsimit gjithëpërfshirës në Kosovë

Sipas Konventës së të drejtave të fëmijës:

“Fëmijë konsiderohet personi nën moshën 18 vjeçare, pavarësisht se ligjet nacionale e njohin moshën e pjekurisë më herët”. Fëmija me nevojë të veçanta “ka të drejtë për kujdes të veçantë, për arsimim dhe trajnim, për t’i ndihmuar që të gëzojë jetë të përshtatshme me dinjitet të plotë dhe të arrijë dinjitetin më të lartë të vetëbesimit dhe mundësi të integritetit social”.

Fëmijët me nevojë të veçanta kanë të drejta të njëjta sikurse fëmijët e tjerë. Ato të drejta përfshijnë:

- Të drejtën për t’u vlerësuar dhe respektuar para se gjithash si fëmijë;
- Të drejtën për shërbime që mbështesin një jetë si të të gjithë të tjerëve;

- Të drejtën për t'u mbrojtur nga dëmtimet apo nga ndonjë keqtrajtim;
- Të drejtën për t'u mbrojtur nga diskriminimi;
- Të drejtën për jetë private personale;
- Të drejtën për arsimim;
- Të drejtën për të pasur të drejtë në gjithë sistemin e kujdesit shëndetësor;
- Të drejtën për të përfituar të njëjtat shërbime si të gjithë fëmijët e tjerë;
- Të drejtën për të luajtur dhe për të pasur të drejtë në të gjitha aktivitetet e kohës së lirë;
- Të drejtën për të shprehur idetë e tyre dhe të drejtën që këto ide të merren në konsideratë;
- Të drejtën për informacion, këshillim apo mbështetje;
- Të drejtën për t'u ankuar kur personat që u ofrojnë shërbime, nuk punojnë si duhet. (Zabeli, Nxënësit me nevoja të veçanta, 2001)

Sipas Ligjit mbi Arsimin Fillor dhe të Mesëm në Kosovë (LIGJI Nr. 04/L-032)⁵, të gjithë fëmijëve u sigurohet e drejta për arsim. Kjo do të thotë se të gjithë fëmijët kanë të drejtë të vijnë shkollimin, përfshirë këtu edhe fëmijët që kanë dëmtime dhe vështirësi në të nxënë. Fëmijët me dëmtime fizike, në të dëgjuar, në të parë, çrregullime emocionale dhe të sjelljes, si dhe fëmijët me vështirësi të rënda në të nxënë, vështirësi në të komunikuar dhe gjuhësore, gjithashtu duhet të jenë të përfshirë në shkolla edhe nuk mund të arrijnë gjithnjë të njëjtat objektiva sikurse nxënësit e tjerë.

Për momentin shumë fëmijë janë jashtë sistemit shkollor, për shkak të llojeve të ndryshme të dëmtimeve dhe vështirësive në të nxënë. Qëllimi i Ministrisë së Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë është që të përmirësojnë gradualisht mjetet ndihmëse për këta fëmijë. Referimet janë që fillimisht të përfshihen fëmijët e grupmoshës 7-14, të cilët nuk janë duke vijuar shkollën. (Pesamaa & Zogu, Edukimi special në Kosovë, 2003) E drejta për arsim është një nga të drejtat themelore të njeriut, gjithëpërfshirja është parim kryesor që e mbështet punën e MASHT-it dhe që është i njohur edhe në legjislacionin e Kosovës. Në bazë të këtij parimi “nxënësit me dëmtime duhet të integrohen në klasat e rregullta në vend se të veçohen në shkolla speciale”. Por pavarësisht se hartimi i ligjeve për këtë të drejtë është në nivele bashkëkohore realiteti ynë në zbatim në praktikë është më ndryshe. E drejta për arsim nuk është ofruar në plotësimin e nevojave dhe të aftësive të çdo nxënësi apo studenti me nevoja të veçanta. Në vijim do t'i paraqesim dokumentet më të rëndësishme politike dhe ligjore në vendin tonë, që mbështesin arsimimin e fëmijëve me nevoja të veçanta në aspektin e gjithëpërfshirjes. Në këto dokumente janë përzgjedhur nenet që theksojnë të drejtën për arsim të fëmijëve me nevoja të veçanta si dhe detyrimet që ka shteti i Kosovës dhe strukturat përgjegjëse për të marrë masat në zbatimin e saj.

⁵ Marrë nga GAZETA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS / Nr. 17 / 16 SHTATOR 2011, PRISHTINË LIGJI Nr. 04/L-032 PËR ARSIMIN PARAUNIVERSITAR NË REPUBLIKËN E KOSOVËS <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2770> Qasur [më 20.10.2020]

Ligji mbi arsimin parauniversitar 2011 - Gjithëpërfshirja si koncept e përshkon tërë ligjin i cili është i bazuar në deklaratën e Salamankes mbi gjithëpërfshirjen dhe Konventën për të drejtat e njeriut. Po ashtu ligji përmban nene të veçanta të cilat rregullojnë arsimin e fëmijëve/nxënësve me nevoja të veçanta. Ligji i ri krijon bazën e mjaftueshme ligjore që sistemi arsimor në Kosovë të jetë gjithëpërfshirës.

Korniza e kurrikulës së Kosovës - Një nga parimet kryesore mbi të cilat është ndërtuar Korniza e kurrikulës së Kosovës është gjithëpërfshirja. Korniza e Kurrikulare është në linjë me Arsimin për të gjithë dhe qëllimet zhvillimore të mileniumit duke synuar të ofrojë qasje të barabartë në arsim cilësor të gjithë nxënësve, pa marrë parasysh gjininë, aftësinë e kufizuar, etnicitetin, moshën, statusin ekonomik dhe shoqëror, ngjyrën e lëkurës, kulturën, gjuhën dhe besimet⁶. Njësia e arsimit special është pjesë e këtij procesi. Sipas Kornizës së re Kurrikulare të Kosovës është një personifikim i artikullimit koherent të qëllimeve dhe objektivave, përmbajtjes, metodave të mësimdhënies dhe të mësuarit, dhe bazë për vlerësim dhe evaluim. Kjo prezanton jo vetëm reflektimin e shoqërisë dhe kulturës së dhënë, por gjithashtu edhe projektimet e së ardhmes se si do të duket shoqëria. Gjithashtu, sheh se si nxënësit do të pajisen për t'u ballafaquar suksesshëm me sfidat e ndryshme dhe situatat e jetës së vërtetë. Në Ligjin mbi Shkollën (2011)⁶, Kurrikula është dokumenti kryesor zyrtar, të cilin mësuesit pritët që ta përcjellin (Pesamaa, Edukimi Special në Kosovë, 2003).

Plani strategjik për Arsimin e Kosovës 2017 – 2021 (PSAK) - Plani Strategjik për Arsimin e Kosovës 2017 -2021 (PSAK) është një plan pesëvjeçar që lidh arsimin gjatë gjithë jetës me përfshirjen në arsim dhe një model për të arritura të të gjithë nxënësve si dhe ofron mundësi të barabarta në arsimim cilësor për të gjithë. Në këtë plan strategjik arsimin e fëmijëve me nevoja të veçanta i referohet Planit strategjik për gjithëpërfshirjen e fëmijëve me nevoja të veçanta në arsimin parauniversitar 2010-2015 dokument ky i cili është hartuar në vitin 2010.

Vlerësimi i PSAK-ut 2011-2016 dhe analiza e gjendjes e bërë nga Grupi Bërthamë, me ndihmën e gjashtë nëngrupeve, ka qënë baza për planifikimin e ri pesëvjeçar. Procesi i planifikimit është organizuar në shtatë fusha tematike që mbulojnë të gjitha segmentet relevante të arsimit në Kosovë:

1. Pjesëmarrja dhe gjithëpërfshirja,
2. Menaxhimi i sistemit arsimor,
3. Sigurimi i cilësisë,

⁶ Marrë nga GAZETA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS / Nr. 17 / 16 SHTATOR 2011, PRISHTINË LIGJI Nr. 04/L-032 PËR ARSIMIN PARAUNIVERSITAR NË REPUBLIKËN E KOSOVËS <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2770> Qasur [më 25.10.2020]

4. Zhvillimi i mësimdhënësve,
5. Mësimdhënia dhe të nxënit,
6. Arsimi dhe aftësimi profesional dhe arsimi i të rriturve,
7. Arsimi i lartë.⁷

Plani strategjik për gjithëpërfshirjen e fëmijëve me nevoja të veçanta në arsimin parauniversitar 2010 – 2015 - Ky plan strategjik veprimi përcakton në mënyrë të strukturuar dhe të integruar se si i duhet qasur dhe se si të trajtohet çështja e procesit të gjithëpërfshirjes, por në aspektin e saj më praktik dhe funksional. Vizioni i kësaj strategjie është “Për një sistem arsimor cilësor për të gjithë fëmijët, duke marrë parasysh dhe respektuar nevojat individuale, interesat dhe mundësitë të secilit fëmijë”. MASHT i referohet këtij plani strategjik për arsimin e fëmijëve me nevoja të veçanta.

Plani individual i arsimit PIA (dokument pedagogjik) - Plani individual i arsimit (PIA) është dokument zyrtar pedagogjik i cili hartohet për fëmijët me nevoja të veçanta arsimore, për të cilët ekipi vlerësues i ekspertëve të fushave të ndryshme zhvillimore ka marrë vendimin për edukim dhe arsimim me nevoja të veçanta. Plani Individual i Arsimit shërben për planifikimin sistematik të edukimit, mësimdhënies, për mbështetjen dhe përcjelljen e përparimit individual të fëmijës në mësim. Plani është duke u zbatuar në shumë institucione arsimore në gjithë Kosovën.

Kurrikula në edukimin special – politika e kurrikulës të inkluzionit/gjithëpërfshirjes kërkon që të gjithë nxënësit në shkollat speciale, klasat e bashkangjitura dhe në klasat e integruara të vijnë në kërkesat e njëjta të bërthamës së kurrikulës sikurse nxënësit në klasat e rrjedhës së rregullt, por në bazë të Planit Individual të Arsimit (PIA), të përcjellë nga procedurat e vlerësimit dhe evaluimit individual. (Korniza e Re e Kurrikulës së Kosovës, Prishtinë 2001).

Në ligjin mbi arsimin fillor dhe të mesëm, në kapitullin mbi të drejtat për arsim special (kapitulli VII, nëni 35.3) thuhet: Nxënësit që përfitojnë arsim special kanë të njëjtin numër total të orëve mësimore si nxënësit e tjerë.⁸

Përmbajtja e mësimdhënies – në rastin e arsimit special, dispozitat në këtë Ligj dhe dokumentet plotësuese të nxjerra në bazë të këtij ligji lidhur me përmbajtjen e mësimdhënies zbatohen në atë masë që ato janë të aplikueshme. Për nxënësit që janë në arsim special përgatiten programe

⁷ Marrë nga http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/PLANI_STRATEGJIK_I_ARSIMIT_NË_KOSOVE.pdf Qasur [më 14.10.2020]

⁸ Gazeta Zyrtare e Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes në Kosovë / PRISHTINË: VITI I / NR.8 / 15 DHJETOR 2006 81 LIGJI NR. 2002/2

mësimore individuale. Në këto programe përshkruhen synimet dhe përmbajtja arsimore si dhe mënyra e realizimit të mësimdhënies.

KAPITULLI III

EDUKIMI INKLUZIV

3.1 Integrimi i fëmijëve me nevoja të veçanta

Termi “Inkluzion” është me prejardhje latine: *inclusio*, që në gjuhën shqipe do të thotë përfshirje në vetvete, përkatësisht gjithëpërfshirje. Si i tillë, kohëve të fundit, ka hyrë në terminologjinë pedagogjike shqip sikurse edhe shumë tërma të huaj. Për të njëjtin kuptim, ky term përdoret edhe në gjuhën angleze, frënge, italiane etj.

Integrimi i fëmijëve me nevoja të veçanta qoftë në institucionet parashkollore ose shkollore ka filluar të aplikohet disa vite më parë në shumë vende të botës dhe është implementuar në mënyra të ndryshme. Në disa vende të botës si në SHBA e veçmas në disa vende të Evropës perëndimore idetë për integrimin e fëmijëve në shkolla të rregullta nisën në fillim të viteve të 60-ta të shek. XX. Tani në shumë sisteme arsimore të disa vendeve inkluzioni është bërë realitet por i shoqëruar me vështirësi të pritshme.

Inkluzioni nënkupton barazi në arsim dhe shkollim. Shpeshherë e shumëkush mendon se fëmijët me nevoja të veçanta kanë edhe të drejta të veçanta. Në fakt, jo. Sipas Konventës për të drejtat e fëmijëve, fëmijët me nevoja të veçanta kanë të njëjtat të drejta sikurse fëmijët e tjerë. Fëmija me nevoja të veçanta “ka të drejtë për kujdes të veçantë, për arsim dhe për trajtim, për t’i ndihmuar që ta gëzojë një jetë të përshtatshme me dinjitet të plotë dhe të arrijë dinjitetin më të lartë të vetëbesimit dhe mundësi të integritit social”.⁹

⁹Fletë informacioni, FSHDP, Tiranë, 2001.

Një e drejtë themelore, është e drejta për arsim. Këtë të drejtë duhet ta gëzojnë të gjithë fëmijët pa dallim racë, feje, gjinie, gjuhe a të diversiteteve eventuale që mund t'i kenë, d.m.th pa marrë parasysh dëmtimet e natyrës fizike, prapambetjen mendore apo vështirësitë emocionale dhe të sjelljes. Thjesht, inkluzion do të thotë se shoqëria nuk ka persona për t'i hedhur, për t'i përjashtuar sepse:

- Të gjithë jemi të ndryshëm, të gjithë duhet të jemi të barabartë;
- Të gjithë jemi të ndryshëm dhe të gjithë kemi nevoja të veçanta (Zabeli, Edukimi inkluziv)

Kjo do të thotë se të gjithë kanë të drejtë për të pasur qasje në edukim, respektim të ndryshimeve, përqendrim në të gjitha barrierat eventuale.

Shikuar nga ky këndvështrim, shkolla duhet të jetë vend:

- ku të gjithë konsiderohen të mirëseardhur dhe kanë mundësi të marrin pjesë në punën e saj;
- e cila i takon secilit si anëtar i cili është i barabartë dhe i rëndësishëm;
- në të cilën nxënësit dhe të rriturit përkrahin njëri-tjetrin në të gjitha aspektet etj. (Susan & Stainback, 2000)

Shkolla inkluzive është organizatë e cila i zgjidh problemet e ndërthurura dhe u ofron shanse të barabarta për edukim të gjithëve pa as më të voglin dallim. Në shkollë inkluzive, fëmija me nevoja të veçanta bëhet:

- pjesëtar i barabartë i grupit;
- përfshihet bashkërisht me të tjerët në procesin e të nxënës;
- përfshihet në të gjitha aktivitetet e shkollës;
- bëhet i vetëdijshëm se është person sikurse të tjerët etj.

Ndërsa, mësimdhënësi inkluziv:

- beson në aftësitë e secilit;
- beson në mundësinë e secilit për të bërë diçka;
- është i vetëdijshëm se nxënësi është më i rëndësishëm se sa përmbajtjet kurrikulare;
- se përmbajtjet mësimore duhet t'u përshtaten aftësive psiko-fizike të nxënësve;
- se nxënësit mësojnë më mirë së bashku se sa ndaras;
- se socializmi i tyre është i një rëndësie të veçantë etj. (Zabeli, Edukimi inkluziv, 2003)

James Hymes thotë, se “prindërit e njohin më së miri fëmijën e tyre, ata e njohin egocentrizmin e tyre, njohin sjelljet e tyre të ndrojtura, motivet e tyre, imagjinatën e tyre, shkallën e socializmit të tyre etj. Ata kanë jetuar me fëmijët e tyre që në ditët e para të ardhjes në jetë”.

Pra prindërit mund të ngritin kualitetin e fëmijëve të tyre në mësim, duke bashkëpunuar me profesionistët e tjerë. Prindërit janë ata që e njohin më së miri fëmijën e tyre, çdo ndryshim i vogël, ngritje apo rënie e fëmijës në mësim dhe në sjellje duhet të vërehet dhe përcillet nga prindërit. Prandaj, është shumë i rëndësishëm komunikimi i vazhdueshëm me familjen dhe pse jo edhe përfshirja e saj në aktivitetet e ndryshme në kuadër të shkollës.

Nga tërë kjo mund të themi se inkluzioni kërkon përkrahje në krijimin e kapaciteteve të reja nëpër shkolla drejt një përballimi në eliminimin e diferencave në procesin e nxënies për fëmijët. Që të gjithë fëmijët, njerëzit dhe të rinjtë, prindërit, kujdestarët e tyre kanë vlerë, dhe që diferencat në mes tyre janë një motiv më tepër për përkrahje në procesin e nxënies.

3.2 Shkolla e hapur për të gjithë

Shkolla qëndër komunitare, një shkollë miqësore për të gjithë është një qasje (lëvizje promovuese dhe zhvilluese) për ta kthyer shkollën në vendin ku ndërtohet partneriteti shkollë-familje-komunitet dhe bashkëpunohet për zhvillimin e potencialit të plotë të çdo nxënësi.

Koncepti i shkollës qëndër komunitare, mbështetet në Konventën për të Drejtat e Fëmijës, dhe paraqet një qasje gjithëpërfshirëse që ndërlidh të gjithë aspektet e reformës në arsim me vendosjen e fëmijës në qendër të vëmendjes në të gjitha veprimtaritë që organizohen dhe zbatohen në shkollë.

Përfitimet që ofrojnë shkollat komunitare janë të shumta dhe të shumëfishta. Ato sigurojnë, gjithëpërfshirje pa dallime gjinore e të natyrave të tjera, arritje më të mira të fëmijëve dhe të rinjve, garanci për një shëndet më të fortë, pjesëmarrje aktive në vendimmarrje të nxënësve, përfshirje dhe kontribut të gjerë të familjes, hapje ndaj komunitetit dhe strukturave vendore dhe mbrojtje për fëmijët dhe të rinjtë.

Shkolla ofron kurse akademike (si kurset e shkencës, kurse plotësuese për nxënësit me vështirësi, etj.), të cilat nuk i mbivendosen programeve dhe përvojave të nxënësit në orën e mësimi.

3.3 Sigurimi i arsimit cilësor për çdo nxënë

Shkolla, familja dhe komuniteti bashkëpunojnë për të mbështetur, pasuruar dhe nxitur të nxënit e fëmijëve dhe të rinjve, përmes veprimtarive formale dhe joformale, brenda dhe jashtë shkolle. Shkolla integron programe dhe shërbime që mbështesin zhvillimin akademik të nxënësve dhe plotësojnë nevojat dhe interesat e tyre.

Përbushja e nevojave dhe interesave të nxënësve

- Shkolla nxit veprimin dhe pjesëmarrjen e nxënësve për çështje që lidhen me suksesin e tyre në shkollë e jashtë saj;
- Nxënësit dhe prindërit marrin pjesë në procesin e planifikimit dhe zhvillimit të kurrikulës në shkollë;
- Prindërit bashkëpunojnë me stafin e shkollës për të njohur stilet e të nxënësve;
- Shkolla, në bashkëpunim me prindërit identifikojnë treguesit kryesorë që masin progresin e nxënësve;
- Shkolla zhvillon programe të veçanta për nxënësit e talentuar dhe nxënësit me vështirësi në të nxënë.

3.4 Sigurimi i mirëqënies sociale, emocionale dhe shëndetësore të nxënësve

Shkolla bashkëpunon me prindërit dhe partnerët e komunitetit për të njohur, për të adresuar dhe për të përbushur nevojat fizike, emocionale dhe sociale të nxënësve si dhe për të garantuar zhvillimin e tyre të shëndetshëm. Ato, së bashku, ofrojnë programe (që përfshijnë veprimtari fizike, e sportive, programe për të ushqyerin e shëndetshëm, veprimtari kulturore etj.), të cilat kontribuojnë në përmirësimin e arritjeve të nxënësve dhe të klimës në shkollë.¹⁰

Shkolla është një institucion dinamik që po ndryshon shumë nga e kaluara. Mësuesi dhe nxënësi, në kushtet e shkollës moderne nuk duhet të jenë rivalë, përkundrazi duhet të jenë bashkëpunues, partnerë, që kanë një mision të përbashkët. Në çdo kuptim që në do ta shikojmë shkollën, ajo është dhe do të jetë një institucion jo vetëm pedagogjik, por edhe i marrëdhënieve të demokratizuara midis mësuesit dhe nxënësit, por edhe komunitetit.

Principet e ndryshuara dhe të demokratizuara të shkollës shpesh sjellin konflikt, ashpërsi, brutalitet, vrazhdësi. Jeta e përditshme shkollore, krahas konflikteve nxënës - nxënës, përmbajnë edhe konfliktet nxënës-mësues. Konfliktet mësues - nxënës janë nga më delikatet në shkollë dhe është e pamundur të mos ekzistojnë. Ato kërkojnë shumë vëmendje, kujdes, ndjeshmëri e profesionalizëm. Nxënësi vjen në shkollë së bashku me problemet ditore të tij, siç janë konfliktet familjare të natyrave të ndryshme. Shumë nxënës e përjetojnë rëndë divorcin e prindërve, disa të tjerë kanë kushte të vështira ekonomiko-sociale, keqtrajtime, sëmundje të anëtarëve të familjes. E në këto raste vetë nxënësi kalon nëpër një krizë të rëndë psikologjike.

¹⁰Ministria e Arsimit dhe Sportit, *Standardet e shkollës si qendër komunitare*, Tiranë, 2014, fq. 3,12,13.

Nëse nxënësi këtë ngarkesë psikike nuk e komunikon dhe shtjellon me ndonjë profesionist qoftë brenda shkollës qoftë jashtë saj, atëherë kjo ndjenjë e rënduar e nxënësit do të rezultojë në një konflikt të ashpër në shkollë, si ndaj mësuesit ashtu edhe ndaj nxënësve. Por, duke u nisur nga ajo se shkolla kërkon paqe, stabilitet, qetësinë e vërtetë e jo të rreme por edhe shumë punë e përkushtim, në vetvete ajo nënkupton zgjidhjen. Fëmijët duhet të ndjehen të sigurt, të mos kenë diversitete, të mësojnë e të punojnë së bashku, të ndihmojnë dhe të ndajnë gjithçka me njëri-tjetrin.

3.5 Angazhimi dhe zhvillimi i komunitetit

Shkolla ofron shërbime që shërbejnë për zhvillimin e komunitetit, dhe komuniteti është pjesë përbërëse e aktiviteteve që organizon shkolla. Në këtë mënyrë nuk përfiton vetëm komuniteti nga shkolla por edhe shkolla bashkëpunon me komunitetin për rritjen dhe përmirësimin e rezultateve për nxënësit. Prania e prindërve në shkollë dhe njohja me nevojat e nxënësve do të thotë më pak stres për familjarët dhe rezultate më të larta për nxënësit.

Komuniteti jep ide për planet që ndikojnë në rritjen e performancës së nxënësve, ata marrin pjesë nëpërmjet punëve vullnetare në shkollë, ose në raste të veçanta mundësojnë fonde për zhvillimin e shkollës. Prindërit mund të mblidhen në shkollë nëse kanë nevojë për të diskutuar, për të përmirësuar kushtet e shkollës apo për të përmirësuar marrëdhëniet mësues-nxënës-prindër. Gjithashtu janë të gatshëm të ndihmojnë në raste të problemeve dhe vështirësive të veçanta të çdo nxënësi. Ata mund të bashkëpunojnë që shkolla të ketë program formal për vullnetarizmin. Shkolla ofron shërbime psikologjike, sociale, ligjore në rast nevojë të komunitetit. Shkolla ndërgjegjëson komunitetin për rëndësinë e respektimit të diversitetit.¹¹

Shkolla dhe komuniteti kanë një lidhshmëri reciproke mes vete. Shkolla është bazë për ndërtimin e kuadrove të reja tek çdo institucion. Por, edhe komuniteti ka rolin e vet të pazëvendësueshëm në edukimin dhe informimin e fëmijëve në lëmi të ndryshme.

Janë të njohura rastet kur shkollat i kanë vizituar këshilltarët mjekësorë, të cilët i kanë informuar nxënësit për rëndësinë e shëndetit, sëmundjet dhe infeksionet e ndryshme, e gjithsesi edhe mundësinë e parandalimit të tyre. Edhe shërbimi policor ka dhënë kontributin e vet për informimin e nxënësve rreth elementeve shërbyese të trafikut rrugor, mjeteve piroteknike etj.

Një nga kontributet komunitetit është edhe vullnetarizmi i organizuar nga prindërit, kjo ka qënë një shtyllë e lartë, e cila ka bërë që shumë nxënës të ndihmohen në aspektin financiar. Nga ky virtut i lartë komunitar kanë përfituar shumë nxënës, përfitimet kanë qënë të natyrës shëndetësore, mjeteve shkollore, ekskursionet, etj.

¹¹ Ministria e Arsimit dhe Sportit, *Standardet e shkollës si qendër komunitare*, Tiranë, 2014, fq. 15-16.

KAPITULLI IV

4.1 Njohuritë rreth sindromës Daun

Në këtë kapitull është dhënë një shqyrtim i përgjithshëm rreth shkaqeve, paragjykimeve dhe termeve që zakonisht i hasëm për fëmijët me sindromën Daun, përfshirja në shkolla të rregullta të këtyre fëmijëve.

4.2 Çka është sindroma Daun

Fjala sindromë Daun për herë të parë u dëgjua në fund të shekullit XIX nga John Langdon Down ku botoi një përshkrimi të saktë që i përkasin individit me sindromën Daun të cilën e botoi në një punim akademik në vitin 1866 ku edhe u emërua sindroma nga mbiemri i tij, Down, edhe pse edhe njerëzi tjerë kishin njohuri për karakteristikat e sindromës, por ishte John Langdon Down i cili e përshkroi gjendjen si entitet të veçanta.


Në çdo qelizë të trupit të njeriut ekziston një bërthamë, ku ruhen materiali gjenetik. Ku gjenet mbajnë kod përgjegjëse për të gjitha tiparet tona të trashëguar ku janë të grupuara dhe të quajtura kromozome, trupi i njeriut është i përbërë nga qelizat, ku çdo qelizë në trupin e njeriut përmban 46 kromozome, ku 23 kromozome janë të trashëguara nga njëri prind (baba) dhe 23 të tjera nga tjetri prind (nëna). Sindroma Daun ndodh atëherë kur një individ ka një kopje të plotë ose të pjesshme të kromozomit të 21-të ku kjo mund të ndodhë si pasojë e një ndarjeje anormale qelizore, dhe si rezultat individ i kësaj ndarjeje tashmë ka 47 kromozome, pra një më shumë për çdo qelizë ose në një pjesë të qelizave në trupin e vet. Nga kjo ndarje e qelizave, gjenetika ndryshon rrjedhjen e zhvillimit dhe vjen deri të shkaktojë dhe karakteristikat që lidhen me sindromën Daun (NDSS National Down Syndrom Society, 2017)

4.3 Tipet e sindromës Daun

Ekzistojnë tri tipe të sindromës Daun:

1. Trisomia 21 (Trisomy 21)
2. Mozaicizmi (Mosaicism)
3. Translokacioni (Translocation)

NORMAL CELL DIVISION




¹²Figura 1. Ndarja normale e qelizave

Trisomia 21 (Trisomy21) - ndodh kur në çiftin e 21-të të kromozomeve kemi një kromozom shtesë në çdo qelizë të trupit tonë. Kjo është forma më e përhapur e sindromës Daun, e 95 % të rasteve në botë.

¹² Marrë nga <https://cmdss.org/parent-guide/about-down-syndrome/types-syndrome/> Qasur [më 05.01.2021]


TRISOMY 21 (NONDISJUNCTION CELL DIVISION)



¹³ Figura 2. Trisomia (ndarja jo qëllore e qelizave)

Mozaicizmi (Mosaicism) - ndodh kur kemi një miks të qelizave, disa qeliza përmbajnë 46 kromosome e disa 47 kromosome. Këto qeliza me 47 kromosome përmbajnë një kromozom shtesë 21

MOSAIC CELL DIVISION



¹⁴ Figura 3. Ndarja e qelizave mozaicizmi

¹³ Marrë nga <https://cmdss.org/parent-guide/about-down-syndrome/types-syndrome/> Qasur [më 05.01.2021]

Mozaicizmi është forma më pak e zakonshme e sindromës Daun. Ajo përbën vetëm rreth 1% të të gjitha rasteve të sindromës Daun. Hulumtimet tregojnë se individët me sindromën mozaicizmit Daun mund të kenë më pak karakteristika të sindromës Daun sesa ata me lloje të tjera të sindromës Daun. Sidoqoftë, përgjithësimet e gjera nuk janë të mundshme për shkak të gamës së gjerë të aftësive që kanë njerëzit me sindromën Daun.

Translokacioni (Translocation) – numri i kromosomeve është 46, por një kopje e kromozomit të 21-të, i plotë ose i pjesshëm i bashkangjitet një kromozomi tjetër, zakonisht kromozomit të 14-të. Translokacioni është forma e vetme sindromës Down e cila ka komponent trashëgues, dhe përbën 4% të rasteve në botë. Prania e kromozomit 21 shtesë ekstra i plotë ose i pjesshëm shkakton karakteristikat e sindromës Daun¹⁵ (Central Mississippi Down Syndrome Society, 2018)

4.4 Mitet dhe faktet për fëmijët me sindromën Daun

Ekzistojnë shumë të pavëreta rreth personave me sindromën Daun që njihen në mbarë botën po ashtu edhe Kosova nuk mund t'i ikën kësaj që të flitet apo të supozohet për shumë gjëra që nuk janë të vërteta rreth fëmijëve apo personave me sindromën Daun. Në shumë vend të ndryshme institucionet kanë hartuar ligje apo politika që të bëjnë një informim sa më të mirë rreth këtyre fëmijëve që në shumë vende të botës janë të diskriminuar apo thirrur me emera të ndryshme që tingëllojnë shumë fyes apo edhe nënshtrues. Në vazhdimi do t'i përmendim disa nga këto pika që i hasim shpesh në mes bisedash tona po në fakt nuk ekzistojnë

Mit: Sindroma Daun është një çrregullim i rrallë.

E vërtëta: Sindroma Daun është gjendja kromozomale më e zakonshme. Përafërsisht një në çdo 700 foshnjat në Shtetet e Bashkuara lindin me sindromën Daun, ose rreth 6,000 lindje në vit

Mit: Sindroma Daun është e trashëgueshme dhe zhvillohet në familje.

E vërtëta: Translokimi, një lloj i sindromës Daun që përbën 3 deri në 4% të të gjitha rasteve, është lloji i vetëm i Daunit sindroma që dihet se ka një përbërës të trashëgueshëm. Prej tyre, një e treta (ose 1% e të gjitha rasteve të sindromës Daun) janë trashëgues.

Mit: Prindërit nuk do të gjejnë mbështetje nga komuniteti në edukimin e fëmijës së tyre me sindromën Daun.

¹⁴ Marrë nga <https://cmdss.org/parent-guide/about-down-syndrome/types-syndrome/> Qasur [më 05.01.2021]

¹⁵ https://cmdss.org/wp-content/uploads/2018/06/CMDSS_NPG2018.pdf

E vertëta: Pothuajse në çdo komunitet të Shteteve të Bashkuara ka grupe mbështetëse për prindërit dhe komunitet tjetër organizata të përfshira drejtpërdrejt në ofrimin e shërbimeve për familjet e individëve me sindromën Daun gjithashtu edhe në Kosovë kemi grupe mbështetëse¹⁶

Mit: Personat me sindromën Daun nuk mund të jenë anëtarë aktivë të komunitetit të tyre.

E Vertëta: Personat me sindromën Daun janë pjesëmarrës aktivë në aktivitete arsimore, shoqërore dhe rekreative. Ata janë të përfshira në sistemin tipik arsimor dhe të marrin pjesë në sport, muzikë, programe arti dhe çdo aktivitet tjetër në bashkësi. Njerëzit me sindromën Daun janë anëtarë të vlerësuar të familjeve dhe komuniteteve të tyre, dhe bëhen domethënës kontributet për shoqërinë.

Mit: Programet e veçuara të arsimit special janë opsioni i vetëm për studentët me sindromën Daun.

E Vertëta: Nxënësit me sindromën Daun përfshihen në klasat akademike tipike në shkollat në të gjithë vendin. Trendi aktual në arsim është përfshirja e plotë në mjediset shoqërore dhe arsimore. Ndonjëherë nxënësit me sindromën Daun përfshihen në kurse specifike, ndërsa në situata të tjera nxënësit përfshihen plotësisht në klasën tipike për të gjitha lëndët. Gjithnjë e më shumë, individët me sindromën Daun mbarojnë shkollën e mesme me diploma dhe marrin pjesë në shkollim të mesëm.

Mit: Të rriturit me sindromën Daun janë të papunë.

E Vertëta: Bizneset punësojnë të rriturit me sindromën Daun për një larmi pozicionesh - në banka, korporata, hotele, spitale, shtëpi pleqsh, zyra dhe restorante. Ata punojnë në industrinë e muzikës dhe argëtimit, në pozita klerikale, kujdesi për fëmijët, fusha e sporteve dhe industria e kompjuterit, për të përmendur disa. Si kushdo tjetër, njerëzit me sindromën Daun dëshirojnë të kenë një punë ku do të vlerësohet puna e tyre.¹⁷

Mit: Njerëzit me sindromën Daun janë gjithmonë të sëmurë.


E Vertëta: Megjithëse njerëzit me sindromën Daun janë në një rrezik në rritje për kushte të caktuara mjekësore të tilla si të lindura defektet e zemrës, problemet e frymëmarrjes dhe dëgjimit dhe gjendjet e tiroides, përparimet në kujdesin shëndetësor dhe trajtimin e këtyre kushtet kanë lejuar që shumica e individëve me sindromën Daun të bëjnë jetë të shëndetshme (Syndrome, 2015).

¹⁶ Ju mund të gjeni një listë të grupet në [Punëtoritë & Produktet | Down Syndrome Kosova](#)

¹⁷ Shoqata *Down Syndrome Kosova* në vitin 2015 ka filluar projektin **AMË**. Në kuadër të këtij projekti personat me sindromë Down aftësohen në paketimin dhe shitjen e mjalit natyror, nën markën **AMË**. Ky projekt, është projekti i parë i këtij lloji në Kosovë, i cili theksojë rëndësinë e punësimit të individëve me aftësi të kufizuara në Kosovë. [Punëtoritë & Produktet | Down Syndrome Kosova](#)

4.5 Rreth sindromës Daun në Kosovë

- Sipas Agjencisë së Statistikave të Kosovës “Statistikat e Lindjeve për vitin 2019” brenda territorit të Kosovës janë lindur 21798¹⁸. Në bazë të të dhënave të Shoqatës *Down Syndrome Kosova*, në Kosovë brenda vitit lindin rreth 35-40 foshnja me sindromë Daun¹⁹, që nëse i krahasojmë me numrin e lindjeve brenda vitit i bie përafërsisht 1 në 622 lindje në Kosovë mund të jenë me sindromën Daun.



Grf. 1. Përqindja e lindjeve me sindromën Daun në Kosovë

- Ka rreth 920 persona me sindromën Daun në Kosovë

¹⁸ Marrë nga: Agjencia e Statistikave të Kosovës ,Statistikat e Lindjeve 2019, <https://ask.rks-gov.net/media/5455/statistikat-e-lindjeve-2019.pdf>

¹⁹ Marrë nga: Down Syndrome Kosova <http://www.downsyndromekosova.org/cfare-eshte-sindroma>

- Bazuar në shumë shkirime të ndryshme supozohet që 80% të rasteve nënat janë ato që baritn kromozonin ekstra. Nga kjo del që përafërsisht 80% e fëmijëve me sindromën Daun lindin nga nëna nën moshën 35 vjeç, po gjasat apo shkalla e rastëv më e lartë është për gratë mbi 40 vjeç ku në moshën 40 vjeç gjasat për të pasur një fëmijë me sindromën Daun është afërsisht 1 në 110 lindje, ndërsa nga mosha 45 vjeç rreziku bëhet dukshum më i lartë pra gjasat që të lindë një fëmijë me sindromën Daun është 1 në 35 lindje.
- Duke u bazuar në (Agjencia e Statistikave të Kosovës, 2019) del që numri më i madh i nënave që kanë lindur fëmijë, është i grupmoshave 25-29 vjeç me 35.5%, grupmoshave 30-34 vjeç me 26.7%, grupmoshave 20-24vjeç me 18.6%, dhe grupmoshat e tjera përbëjnë 19.1% të numrit të përgjithshëm të lindjeve (Agjencia e Statistikave të Kosovës, 2019). Mosha mesatare e femrave që kanë lindur fëmijë në vitin 2019, është 29 vjeç.²⁰
- Duke u bazuar në statistikën e Kosovës del që Kosova nuk qëndron keq pasi që mosha mesatar e nënave që lindin është 29 vjeç.
- Në statistikën e Kosovës mungojnë të dhëna për lindjet e fëmijëve me nevoja të vçanta pra edhe për fëmijët me sindromën Daun nuk është e cekur se sa prej këtyre lindjeve janë fëmijë me nevoja të veçanta përveçqë përfshin të lindur dhe sa prej këtyre të lindurve janë të gjallë dhe sa kanë vdekur, pra nuk tregohet arsyeja e vdekjes përveçqë tregohet se kanë vdekur pra nuk është e cekur arsyeja dhe nuk mund ta dimë sa prej këtyre fëmijëve që nuk arrijnë të jetojnë janë me sindromën Daun, pra të vetmen statistikë që mund ta marrim është vetëm nga shoqata e Down Syndrome Kosova.

4.6 Përkrahja e përfshirjes së nxënësve me sindromën Daun në shkollat të rregullta

Megjithëse fëmijët me sindromën Daun kanë nevoja të shumta dhe kërkesa shtesë arsimore, kërkesat e tyre nuk dallojnë shumë nga kërkesat e njëjta me nxënësit e tjerë që janë me nevoja të veçanta por që dallojnë nga nxënësit me shkallë të invaliditetit të moshës së tyre. Nxënësit me sindromën Daun do të bëjnë përparimin më të shpejtë nëse përfshihen plotësisht në shoqëri dhe pranohen në mjedise të shkollës, duke përfituar nga modelet e përshtatshme për moshën dhe nga përfitimet e ndjenjës se janë pjesë e komunitetit të zakonshëm. Ky pranim shoqëror apo pranimi nga nxënësit e tjerë në mjedise shkollore do të ketë një efekt të thellë në vetëbesimin, vetë-identitetin dhe vetëvlerësimin nëse i gjithë komuniteti shkollor është ai që është i kujdesshëm dhe mbështetës.

²⁰ E marrë nga: Agjencia e Statistikave të Kosovës <https://ask.rks-gov.net/media/5455/statistikat-e-lindjeve-2019.pdf>

Për arritjen e përfshirjes së suksesshme në shkollë, parashikuesi më i rëndësishëm i suksesit është qëndrimi i stafit ndaj këtyre fëmijëve. Që stafi të jetë në gjendje të pranojë nxënës me sindromën Daun apo edhe nxënës që i përkasin nxënësve me nevoja të veçanta duhet të jetë i përgatitur dhe i trajnuar mirë përveç arritjeve që i kanë shkencorë duhet që të jenë të njoftuar me specifikat e këtyre nxënësve pra të jenë të familjarizuar me problemet apo kërkesat që i kanë nxënësit me sindromën Daun. Stafi duhet të ndihet pozitiv në lidhje me përfshirjen dhe të besojë se fëmija qoftë me sindromën Daun qoftë me nevojë të tjera të çanta duhet të jetë në shkollën e tyre. Pra si një pikë mbështetëse për këta nxënës është përkrahja nga stafi i shkollës që të jetë një ambient shumë i përshtatshëm për këta fëmijë (Hughes, 2006).

Stafi apo mësimdhënësit duhet të jenë të vetëdijshëm për çdo shqetësim mjekësor që lidhet me sindromën Daun që mund të jenë specifike për nxënësit tuaj që keni në klasë apo në shkollë. Pra siç e dimë nga literatura dhe nga hulumtimet e ndryshme mjekësore, nxënësi me sindromën Daun mund të kenë një varg të shqetësimeve shëndetësore që mund të jenë individuale apo mund të jenë edhe për nxënësit e tjerë për këtë arsye ne, si mësimdhënës duhet të kemi një bashkëpunim të mirë me prindërit e këtyre nxënësve lidhur me aspektin shëndetësor apo shqetësimet që mund t'i kenë këta nxënës dhe t'i përshtatim mësimet si dhe udhëzimet konformë shqetësimeve që mund t'i kenë këta nxënës. Disa nga shqetësimet shëndetësore janë më të zakonshme tek njerëzit me sindromën Daun sesa tek personat apo nxënësit e tjerë apo popullata e përgjithshme. Sidoqoftë duke pasur parasysh kujdesin mjekësor ndaj këtyre nxënësve dhe duke i ditur dhe duke pasur njohuri rreth burimeve të tyre, shumica e këtyre mund të trajtohen ose menaxhohen me sukses.

4.7 Shqetësimet mjekësore që munden t'i kenë nxënësit apo fëmijët me sindromën Daun

Disa nga shqetësimet mjekësore që mund t'i kenë nxënësit (fëmijët) me sindromën Daun do t'i cekim në vazhdim duke u bazuar në disa fakte shkencore lidhur me këta fëmijë.

Infeksionet

Infeksionet e frymëmarrjes janë më të zakonshme tek njerëzit me sindromën Daun, veçanërisht gjatë pesë viteve të para të jetës. Infeksionet e lëkurës dhe fshikëzës gjithashtu kanë tendencë të jenë të zakonshme. Ka prova që njerëzit me sindromën Daun kanë këtë ndjeshmëri të shtuar ndaj infeksionit sepse sistemi i tyre imunitar ka disa anomali, megjithëse mekanizmat e përfshirë mbeten të paqartë.

Problemet me zemër

Problemet e zemrës ndodhin në rreth 47% të individëve me sindromën Daun dhe 10 deri në 15% të foshnjave me sindromën Daun kanë një defekt të rëndë në zemër që kërkon ndërhyrje kirurgjikale gjatë muajve të parë të jetës. Aftësia për të riparuar defektet e mëdha të zemrës ka pasur një ndikim të

madh në mbijetesën e foshnjave për fëmijët me sindromën Daun në vendet me pajisje dhe ekspertizë të përshtatshme. Pothuajse të gjitha foshnjat me sindromën Daun që kanë një defekt të rëndë në zemër do të vdisnin deri në moshën shkollore pa një operacion modern kardiak. Me ndërhyrjen e hershme kirurgjikale, 80% -90% e këtyre foshnjave mbijetojnë pas moshës 5 vjeçare.

Leucemia

Fëmijët me sindromën Daun kanë një rrezik 10 deri në 20 herë të rritur të zhvillimit të leucemisë. Rreziku kumulativ për leucemi deri në moshën 5 vjeç është rreth 2%. Shumë fëmijë me sindromën Daun dhe leucemi akute mund të trajtohen me sukses me trajtimin e duhur.

Tiroide

Çrregullimet e tiroides janë më të përhapura në mesin e individëve me sindromën Daun. Shkalla e saktë dhe mekanizmat e anomalive të tiroides, regjimet efektive të shqyrtimit dhe qasjet e trajtimit mbeten një fushë e hulumtimeve dhe debateve aktive. Pasi të diagnostikohet, hipotiroidizmi mund të trajtohet thjesht dhe në mënyrë efektive, megjithëse kërkohet ky trajtim dhe monitorim i mëtujshtëm gjatë gjithë jetës së individit.

Dëgjimi

Deri në 80% të fëmijëve me sindromën Daun përjetojnë humbje të dëgjimit, ndonjëherë të rënda. Edhe humbja e lehtë e dëgjimit do të çojë në vështirësi në zhvillimin e të folurit dhe gjuhës.

Një numër faktorësh janë identifikuar se kontribuojnë në humbjen e dëgjimit tek njerëzit me sindromën Daun, duke përfshirë rritjen e incidencës së sëmundjeve kronike të veshit, pjesërisht për shkak të ndryshimeve anatomike dhe gjithashtu të përkeqësuar nga sistemet më të dobëta të imunitetit. Problemet e zakonshme përfshijnë dyllin në kanalin e jashtëm të veshit, humbjen përçuese për shkak të 'ngjitjes' në veshin e mesëm, infeksionet e veshit të mesëm dhe humbjen e dëgjimit sensori-nervor.

Dëgjimi është jetik për zhvillimin mendor dhe të mësuarit, veçanërisht për zhvillimin e fjalës dhe gjuhës dhe të aftësive shoqërore. Megjithëse një humbje e lehtë e dëgjimit zakonisht nuk konsiderohet serioze tek fëmijët e tjerë, mund të ketë një efekt të rëndësishëm në të mësuarit për fëmijët me sindromën Daun. Ndërsa 'veshi ngjitës' mund të çojë vetëm në humbje të butë ose të moderuar të dëgjimit (30dB deri 60dB) kjo do ta bëjë dëgjimin dhe fjalët diskriminuese shumë më të vështira për fëmijët që mësojnë fjalë të reja (për shembull, "mace", "kapelë", "mat" dhe "ulur" mund të tingëllojë si "a"). Humbja e dëgjimit gjithashtu do të ndërhyjë në perceptimin e saktë dhe prodhimin pasues të

tingujve të të folurit. Me fjalë të tjera, humbja e dëgjimit do të vonojë përvetësimin e fjalorit dhe do të komprometojë fjalimin e qartë.

Tani janë në dispozicion një sërë ndërhyrjesh për të trajtuar ose përmirësuar efektet e humbjes së dëgjimit. Kur fëmijët kanë vështirësi të fillojnë të flasin për shkak të humbjes së dëgjimit, nënshtrimi mund të ndihmojë gjithashtu. Sidoqoftë, ka ndërlikime të mundshme që shoqërohen me disa trajtime dhe kërkojnë studime gjatësore që ekzaminojnë rezultatet afatgjata të zhvillimit për të hetuar përfitimet e përgjithshme.

Vizioni

Njerëzit me sindromën Daun kanë më shumë të ngjarë të përjetojnë çrregullime të shikimit si shikimi i shkurtër, shikimi i gjatë dhe astigmatizmi. Ata gjithashtu kanë më shumë të ngjarë të kenë vështirësi dhe të përjetojnë vonesa në zhvillimin e fokusimit efektiv, perceptimit të thellësisë dhe mprehtësisë së shikimit. Shumë nga këto probleme mund të korrigjohen për të dhënë vizion të mirë me përdorimin e syzeve.

Probleme me gjumin

Studimet kanë raportuar një incidencë të lartë të shqetësimit të gjumit tek fëmijët dhe adoleshentët me sindromën Daun. Gjumi i dobët mund të çojë në probleme të sjelljes dhe të dëmtojë të mësuarit. Fatkeqësisht, ne nuk kuptojmë sa duhet për diagnostikimin ose trajtimin e problemeve të gjumit tek fëmijët me sindromën Daun.

Çmenduri

Megjithëse indikacionet fiziologjike të shoqëruara me sëmundjen Alzheimer janë të pranishme në vdekje në pothuajse të gjithë njerëzit me sindromën Daun mbi moshën 30 vjeç, prevalenca e vërejtur e çmendurisë së llojit Alzheimer ndryshon shumë. Studimet e fundit të bazuara në popullatë për të rriturit me sindromën Daun kanë vërejtur çmenduri të tipit Alzheimer në afërsisht 10% të atyre të moshës 40 deri 49 vjeç dhe 26% të atyre të moshës 50 e lart.

Çrregullime të tjera psikiatrike

Megjithëse shumica e njerëzve me sindromën Daun nuk kanë çrregullime psikiatrike ose neurobehaviorale, ekziston një prevalencë e rritur e sjelljeve, spektrit të autizmit dhe çrregullimeve të deficitit të vëmendjes tek të rinjtë me sindromën Daun. Një studim ka sugjeruar që incidenca e çrregullimeve të spektrit të autizmit tek fëmijët me sindromën Daun mund të jetë deri në 7% krahasuar me më pak se 1% në popullatën e përgjithshme²¹.

²¹ Marrë nga: Down Syndrome Education <https://www.down-syndrome.org/en-us/about-down-syndrome/health/>

4.8 Njohuritë e mësimdhënësve që duhet t'i kenë në lidhje me nxënësit me sindromën Daun

E dimë që përveç sfidave që janë për integrimin e nxënësve me sindrom Daun në klasa të rregullat kemi edhe një mori të sfidave të tjera që nuk janë po aq të thjeshta apo jo sfidues për integrimin e nxënësve me sindromën Daun. Një sfidë tjetër që është jo pak me rëndësishme është që edhe mësimdhënësit të jenë mirë të informuar lidhur me ngecjet apo vështërsit që do t'i kenë nxënësit me sindromën Daun gjatë mësimnxënies, pra mësimdhënësit duhet të kenë njohuri themelore gjata ballafaqimit ose përballimit me këta nxënës.

Duke u bazuar në shumë fakte apo edhe në hulumtime të ndryshme, fëmijët me sindromën Daun zhvillohen më ngadalë sesa bashkëmoshatarët e tyre, pra kanë ngecje në secilën fazë të zhvillimit krahasuar me moshën që kanë pra ata qëndrojnë për një kohë më të gjatë në një moshë të caktuar, pra kalimi nga një arritur në tjetrën ka kohë më të gjatë. Si pasojë e këtij boshllëku midis nxënësve me sindromën Daun dhe bashkëmoshatarëve të tyre do të zgjerohet me moshën. Shkalla e vonësës ndryshon në të gjitha fushat e zhvillimit, motorik, social, komunikimi, njohja dhe vetë-ndihma. Sidoqoftë nxënësit me sindromën Daun do të ndryshojnë po aq shumë në zhvillimin dhe përparimin e tyre sa fëmijët në zhvillim tipik dhe secili do të ketë talentet dhe aftësitë e tij individuale që mund të kenë talentet e ndryshëm. Nuk ka një specifik që lidhet me punët apo gjërat që nuk mund apo nuk do të jetë në gjendje të arrijë një nxënës apo fëmijët me sindrom Daun me bashkëmoshatarët e tyre përveçqë duhet të ketë koha e të mësuar me dallim me nxënësit e tjerë, pra u duhet kohë shtesë për të arritur gjërat që i arrijnë nxënësit e tjerë.

Në vazhdim do t'i cekim disa prej pikave të forta dhe të dobëta që një nxënës me sindrom Daun mund t'i ketë:

Pikat e forta që ndikojnë në mësimnxënie

- Aftësi për të mësuar dhe përdorur shenjë, gjestin dhe mbështetjen vizuale.
- Aftësi për të mësuar dhe përdorur fjalën e shkruar.
- Aftësi për të mësuar nga materiale pikturave, konkrete e praktike.
- Të etur për të komunikuar dhe për t'u shoqëruar me të tjerët.
- Prirja për të modeluar (kopjuar) sjelljen dhe qëndrimet nga bashkëmoshatarët dhe të rriturit.
- Aftësia për të mësuarit përmes pamjeve vizual.

Pikat e dobëta që ndikojnë në mësimnxënie

- Dëmtimi i dëgjimit dhe shikimit.

- Aftësitë motorike të vonuara.
- Shqiptimi i fjalëve apo shtrebbimi i fjalëve.
- Kanë një kujtesës afatshkurtër gjatë punës.
- Kanë përqendrimi të shkurtër
- Vështirësitë me përgjithësimin e të menduarit dhe arsyetimin e gjërave para të tjerëve (Down Syndrome International).

4.9 Nxënësit me Sindromën Daun në shkolla apo në klasat tuaja dhe sjelljet pozitive ndaj tyre

Personalitetit i nxënësve apo i fëmijëve me sindromën Daun ndryshon po aq shumë sa fëmijët apo nxënësit e tjerë apo shokët e klasës së tyre. Shumica e nxënësve me sindromën Daun janë të shoqërueshëm dhe të sjellshëm. Raste të rralla janë ato që personat me sindromën Daun bëjnë sjellje që nuk janë të ngjashme me sjelljet e personave të tjerë apo bashkëmoshatarëve të tyre, pra edhe nxënësit me sindromën Daun janë në gjendej që t'u përshtaten udhëzimeve apo rregullave të shkollës që do të jenë të zbatueshme për të gjithë nxënësit. Nëse një nxënës me sindromën Daun ka sjellje që nuk është komformë rregulloreve të shkollës duhet që të shqyrtohen arsyet e sjelljes se tij, sepse ka mundësi që kërkesat e tij nuk plotësohen apo disa kërkesa në ambientin shkollor të tij nuk i plotësohen. Për t'i kuptuar kërkesat e tyre apo edhe pengesat që munde t'i kenë apo që mund të vjen deri të një sjellje jo e njëjtë me nxënësit e tjerë stafit i shkollës apo edhe nxënësit e tjerë duhet që të jenë të informuar mirë të keni një bashkëpunim shumë të ngushtë me prindërit gjithashtu edhe përshtatjen e planprogrameve apo edhe ndonjë udhëzues difernucues. Zakonisht një sjellej e tillë mund ta kenë edhe individët të cilët mund të mos e kenë një sistem efektiv të komunikimit verbal.

Në një studimi të NDSS 1996, prindërit dhe mësimdhënësit dhanë këshillat e mëposhtme për menaxhimin e sjelljes në shkollë apo klasë. Në përgjithësi, teknika më efektive për menaxhimin e sjelljes është **lavdërimi**.

Ndonjëherë janë metodat e mëposhtme efektive për menaxhimin e sjelljes tek studentët me sindromën Daun (DOWN SYNDROME ASSOCIATION WEST MICHIGAN; DSAWM, 2010):

- shpërblime materiale,
- koha jashtë,
- presion nga kolegët,
- humbja e privilegjeve, dhe

- kontaktet me prindër

Gjithashtu edhe stafi apo edhe nxënësit e tjerë duhet të kenë disa njohuri lidhur me metodat që nuk janë efektive me nxënësit me sindromën Daun. Metodatat e mëposhtme zakonisht nuk janë efektive për menaxhimin e sjelljes tek nxënësit me sindromën Daun:

- duke injoruar sjelljen e tyre,
- qortimet, dhe
- dënimet.

4.9 Përparësitë e TIK-ut për nxënësit me sindromën Daun

Mund të themi se shek. XXI është shekulli i TIK-ut pasi që pothuajse është përfshirë në secilin sferë të jetës apo në secilin vend të punës dhe në të gjitha nivelet pra nuk është e drejtuar veç tek një sferë apo në një drejtim, por është revolucion i shekullit XXI që edhe njerëzimi pothuajse është duke shkuar nga një jetë digjital. Pra TIK-u ka hyrë fuqishëm edhe ka zënë vend të rëndësishëm në institucionet shkollore po ashtu edhe në universitet për arsye të shumëllojshmërisë dhe interaktivitetit që u jep nxënësve apo edhe studentëve. TIK-u është bërë pjesë e pa ndashëm e institucioneve shkollore për mësimdhënie dhe mësimnxënie ku luan një rol shumë të rëndësishëm në këto dy drejtime. Po ashtu edhe interesimi i nxënësve që mësimi të zhvillohet përmes TIK-ut është mjaft i madh për shkak të pamjeve vizuale që na i ofrojnë softuerët e ndryshme që e bëjnë shumë atraktive mësimnxënien që u mundëson të gjithë nxënësve pa dallim që të kenë pjesën e vet apo edhe të gjenden në njërin nga ata softuerë që na i ofron TIK-u.

Edhe për nxënësit me sindromën Daun një rol shumë të rëndësishëm luan edhe TIK-u nëse mësimdhënësit përdorin këtë kategori të nxënësve kur e dimë që nxënësit me sindrom Daun janë shumë të dhënë pas gjërave vizuale dhe për këtë kategori të nxënësve ka benifite shumë të mëdha, në vazhdim do t'i paraqesim disa përparësi të TIK-ut nëse e përdorim tek nxënësit me sindromën Daun.

Të mësuarit vizual: Fëmijët me sindromën Daun kanë pikat e forta mësimnxënie vizuale dhe e kanë të vështirë të mësojnë vetëm duke dëgjuar mësimdhënësin apo edhe edukatorin duke dhënë shpjegime për të treguar një problem. Mësimdhënësit duke përdorur softuerë të ndryshëm kompjuterikë dhe format e tjera të TIK-ut mund të sigurojnë një burim të stimulimit vizual dhe auditiv për të gjithë nxënësit e në veçanti për nxënësit me sindromën Daun. Nxënësit me sindromën Daun kanë vështirësi të folur dhe karakterizohen nga aftësi e prodhimit të folurit të cilat mbeten prapa

bashkëmoshatarëve të tyre ku nxënësit me sindromën Daun shpesh hasin vështirësi për t'u përgjigjur pyetjeve me gojë. Nëse mësimdhënësit përdorin TIK-un është më e lehtë për ta që të tregojnë mirëkuptimin e tyre ndaj këtyre nxënësve duke përdorur një mënyrë jo-verbale për ta dhënë një përgjigje të tillë, si prekja e ekranit, klikimi i miut ose shtypja e tastit. Duk i kursyer nga dhënia e përgjigjes me anë të shprehjes së gjuhës apo për ta parashtruar pyetjen.

Të jesh në kontroll: Vështirësitë në të folur mund të jenë një burim zhgënjimi për nxënësit me sindromën Daun, i cili mund të shprehet përmes sjelljes së padëshirueshme si një mjet për të kontrolluar njerëzit përreth tyre. Kompjuteri siguron një mjedis ku fëmijët mund të jenë nën kontroll dhe me praktikë mund të punojnë të pambështetur nga ana e mësimdhënësit apo nga edukatori, ku do t'i mundësojë për ta zhvilluar vetëvlerësimin dhe pavarësinë e tyre.

Mundësitë për praktikë dhe shpërblime të menjëhershme: Fëmijët me sindromën Daun shpesh kanë nevojë për më shumë mundësi për praktikë sesa bashkëmoshatarët e tyre në zhvillim. Kompjuteri është në gjendje të paraqesë shanse të pafund për të provuar të njëjtën veprimtari, duke riprodhuar përvojën e saktë pa pushim dhe duke siguruar reagime të palodhshme pozitive në formën e animacioneve, muzikës dhe efekteve zanore.

Të mësuarit pa gabime: Softuerët e përshtatur mirë mund të sigurojnë aktivitetet që u përshtaten niveleve dhe aftësive të fëmijëve në mënyrë individual në një fushë specifike, duke krijuar një përvojë mësimore pa gabime. Kjo do të thotë që fëmija mbështetet nga programi kompjuterik, në mënyrë që të arrijë sukses të përsëritur. E dimë që softuerët mund të programohen për t'iu përgjigjur nevojave të fëmijëve dhe për të modifikuar mënyrën në të cilën ai i paraqet aktivitetet e radhës.

Mjedisi i punës pa rrëmujë: Programet kompjuterike mund të sigurojnë një mjedis punë shumë të organizuar dhe të parashikueshëm që përqendron fëmijën në synime specifike të të mësuarit. Është e rëndësishme të theksohet se ky nuk është rasti me të gjithë programet kompjuterike dhe prindërit dhe profesionistët që punojnë me fëmijë me sindromën Daun duhet të kërkojnë softuer i cili siguron një plan urbanistik të papërzier dhe të thjeshtë pa një larmi të gjerë shpërqëndrimesh dhe komplikimesh.

Frika nga dështimi: Fëmijët me sindromën Daun duket se janë veçanërisht të druajtur për dështimin dhe mund të demonstrojnë një sërë sjelljesh shmangëse për të shpëtuar nga situatat e mësimdhënies që ata i përceptojnë si potencialisht të vështira. Siç u përmend më lart, softueri kompjuterik mund të programohet me kujdes për të përmbushur nevojat individuale dhe aktivitetet mësimore mund të ndahen në faza shumë të vogla. Fëmijët shpejt mësojnë se gabimet mund të ndryshohen shpejt dhe në mënyrë të veçantë.

Teknologjia ndihmëse: Ky term përshkruan gamën e pafund të adaptimeve që mund të bëhen për të përmirësuar inkuadrimin në TIK për përdoruesit me aftësi të kufizuara. Nxënësve me sindromën Daun duhet t'u jepet mundësia si në shtëpi ashtu edhe në shkollë të kenë të njëjtën pajisje dhe softuer si vëllezërit e motrat, miqtë dhe bashkëmoshatarët e tyre dhe kjo përfshin punën për të përdorur miun dhe tastierën. Kjo do t'i lejojë ata të përdorin kompjuterë në një sërë vendesh në komunitetin e gjerë dhe promovon përfshirjen sociale. Sidoqoftë, është e rëndësishme të rishikohen përshtatjet e mundshme që janë në dispozicion (Wood, 2004).

4.10 Aplikacionet apo softuerët e dedikuara për nxënësit me sindromën Daun

Pasi që jemi duke jetuar në epokën e teknologjisë dhe e dimë se TIK-u i ndihmon shumë fëmijët për mësimnxënie dhe e bën shumë më atraktive mësimdhënien dhe mësimnxënien. Përdorimi i teknologjisë apo kompjuterit tek fëmijët me sindrom Daun luan një role shumë të rëndësishëm pasi që njëra nga pikat më të fortë është të mësuarit vizual apo me figura, gjithashtu duke përdorur TIK-un u rritet vetëbesimi. Njëra prej pikave jo të forta janë edhe shprehja me anë të të folurit pasi që e kanë një mangësi të shprehen me anë të të folurit (përmes gjuhës) gjithashtu u jep mundësi për komunikim jo verbal, nëse e shikojmë në këto aspekt përdorimi i kompjuterit apo TIK-ut tek nxënësit me sindromën Daun është një përparësi shumë e madhe ku iu rritet vetëbesimi për arsye që i cekëm më lart. Për këtë arsye, ne duhet të përfitojmë nga mundësitë që na ofrohen nga evolucioni i teknologjisë.

Nuk është e lehtë të krijohen këto lloj të aplikacioneve dhe sigurisht që është shumë vështirë të gjesh një aplikacion që i plotëson kërkesat, por ka disa elemente të detyrueshme që të gjithë duhet t'i dimë kur duam ta krijojmë një aplikacion për nxënësit (fëmijët) me sindromën Daun:

- Aplikacionet duhet të zhvillohen në bashkëpunim me specialistë që njohin të gjitha aspektet e këtij çrregullimi gjenetik.
- Aplikacioni duhet të miratohet nga organizatat e sindromës Daun.
- Me dizajnin e thjeshtë, ata kanë nevojë për të tërhequr dhe angazhuar fëmijët.
- Aplikacionet nuk duhet të përmbajnë elemente shpërqendruese ose të bezdisshme.
- Aplikacionet duhet të marrin në konsideratë të gjitha shtresat e moshës.
- Mjetet mobile duhet të përshtaten me nevojat e fëmijëve.
- Personalizimi është gjithçka kur bëhet fjalë për aplikacionet speciale (quhen speciale pasi që i dedikohen një shtrese të caktuar të personave si p.sh.: fëmijët me sindromën Daun, autizëm, disleksi etj.)

Në vazhdim do t'i paraqesim disa nga aplikacionet që mund të përderen nga nxënësit (fëmijët) me sindromën Daun²², fatkeqësisht nuk kemi hasur në ndonjë aplikacion në gjuhën shqipe që është krijuar për fëmijët me sindromën Daun, aplikacionet që do t'i paraqesim në vazhdim janë në gjuhën angleze, kjo dëshmon që shoqëria kosovare si dhe institucionet gjegjëse nuk kanë një përkushtim ndaj këtyre kategorive që të kenë një integrim sa më të madhe në shoqërinë tonë.

Special Words (Fjalët e veçanta) është një aplikacion që kërkon të adresojë mangësitë në mënyrën e shprehëse, ka aftësi të shkëlqyera të koordinimit të mendjes dhe syrit.

Special Words është një aplikacion që kërkon të mësojë njohjen e fjalëve, gjuhën e folur, vëmendjen dhe aftësitë e dëgjimit, përveç koordinimit të syve me dorë. Aplikacioni përmban 96 fjalë dhe fotografi të përdorura zakonisht gjatë zhvillimit të hershëm të të folurit. Special Words mund të përdoren nga prindërit, mësuesit, ndihmësit e mësimdhënies, terapistët e të folurit për të përmirësuar zhvillimin e të folurit dhe shprehjes pranuese. Special Word është në dispozicion në Android dhe IOS²³




²⁴ Figura 4. Dikja e Special Words

²² Marrë nga <https://www.educationalappstore.com/best-apps/best-apps-for-down-syndrome>

²³ Special Words mund ta shkarkoni në Educational App Store (supporting the wellbeing of children) <https://www.educationalappstore.com/app/special-words-2>.

²⁴ Marrë nga <https://www.educationalappstore.com/app/special-words-2> Qasur [më 10.01.2021]

InnerVoice (Zëri i brendshëm) - është një aplikacion i shkëlqyeshëm i AAC (Augmentative & Alternative Communication). Tani është një ndër aplikacionet më të mira për komunikuesit tanë të rinj, familjet e tyre dhe terapistët të shprehjes së fjalëve. Nuk është aq i komplikuar kur krahasohet me opsionet e tjera të AAC gjatë konfigurimit fillestar dhe përdorimi i strategjive shumëshqisore në kombinimin e stimulimit vizual dhe auditor është i mrekullueshëm. InnerVoice është një aplikacion i menduar mirë dhe i informuar për dizajnin dhe duhet të merret gjithmonë parasysh kur provohet AAC me njerëz me vështirësi në komunikim.



²⁵ Figura 5. Duketja e InnerVoice

CommunicoTool 2 - është një aplikacion i zhvilluar për fëmijët me çrregullime në të folurit (Autizmi, sindroma Daun). Aplikacioni ofron një galeri me imazhe, piktograme dhe tinguj për të ndihmuar fëmijët të shprehen dhe të ndërveprojnë me sukses me botën.

CommunicoTool 2 është një aplikacion mbështetës vizual i komunikimit shtesë dhe alternativ (AAC). Aplikacioni është i përshtatshëm për fëmijët që nuk janë verbalë dhe kanë vonësë gjuhësore.

Një aplikacion vërtet i dobishëm sidomos për fëmijët në spektrin e autizmit dhe sindromën Daun. Të qenët i paaftë për të komunikuar ku dëshirat dhe nevojat themelore mund të jenë

²⁵ Marrë nga <https://www.educationalappstore.com/app/innervoice-communication> Qasur [më 10.01.2021]. Ky aplikacion është në dispozicion vetëm për iPhone dhe iPad në dy gjuhë, anglisht dhe spanisht.

jashtëzakonisht zhgënjyese dhe mund të çojë në ankth të rritur dhe në disa raste sjellje negative. Ky aplikacion ofron mbështetje vizuale për të ndihmuar komunikimin dhe për të minimizuar zhgënjimet. Është në dispozicion për grupe të ndryshëm si psh. aplikacione për 12-18 muaj, aplikacionet e kopshteve (3-5 vjeç), aplikacionet e shkollës fillore (5-7 vjeç), aplikacionet e shkollës fillore (7-11 vjeç), aplikime për shkollën e mesme (11-14 vjeç), aplikime për shkollën e mesme (14-18 vjeç)



²⁶ Figura 6. Dukja e CommunicoTool 2

²⁶ Marrë nga <https://www.educationalappstore.com/app/communicotool-2> Qasur [më 10.01.2021]. Ky aplikacion është në dispozicion vetëm për iPhone dhe iPad vetëm në gjuhën Angleze

KAPITULLI V

GJITHËPËRFSHIRJA E NXËNËSVE ME SINDROMËN DAUN NË SHKOLLAT E RREGULLTA NË SKËNDERAJ

5 Rast studimi - Komuna e Skënderajt

Hulumtimi konformë temës së caktuar është realizuar në komunën e Skënderajt andaj në vazhdim të këtij kapitulli do të njiheni rreth historikut të qytetit të Skënderajt, rreth numrit të banorëve dhe moshën e tyre, rreth numrit qerdheve, shkollave fillore dhe atyre të mesme, pastaj rreth rezultatit të hulumtimit me mësimdhënës dhe prindërit si dhe rezultatet nga intervistat e zhvilluara.

5.1 Qyteti i Skënderajt dhe popullsia e tij

Komuna e Skënderajt ka një sipërfaqe prej 378 km². Në veri kufizohet me komunën e Mitrovicës, në lindje me Vushtrinë, në jugperëndim me Drenasin (Glllogovcin) dhe Klinën, ndërsa në perëndim me Burimin (Istogun). Komuna e Skënderajt si pozicion gjeografik gjendet në qendër të Kosovës, 50 km në veriperëndim të kryeqytetit të Kosovës, Prishtinës. Skënderaj si komunë është e përfshirë në regjionin e Mitrovicës dhe është 20 km në juglindje të këtij qyteti.

Në Komunën e Skënderajt sipas regjistrimeve të fundit të popullsisë në qytet dhe në pesëdhjetë fshatrat e saj banojnë mbi 72 mijë banorë, 99% e popullsisë së kësaj komunë i takojnë komunitetit shqiptar. Në strukturën e popullsisë kryesisht dominon mosha e re dhe atë: 47 % e popullsisë janë nën moshën 20 vjeçare, 48 % e popullsisë janë nga mosha 20-60 vjeç, ndërsa vetëm 5 % e popullsisë janë mbi moshën 60 vjeçe.

Karakteristikë e komunës së Skënderajt është dominimi i moshës së re me 47%, dhe kjo paraqet një potencial të rëndësishëm për zhvillimin ekonomik në të ardhmen. Shtimi natyror ka një shkallë të lartë, mbi 28 promila me një shkallë të ulët të vdekshmërisë rreth 5 promila. Në komunën e Skënderajt sipas burimit nga këshilli komunal i Skënderajt struktura gjinore është, meshkuj 37.485, ose 51,71%, femra 35.005 ose 48,29%.²⁷

5.2 Sistemi edukativo-arsimor në komunën e Skënderajt

Sistemi edukativo-arsimor në komunën e Skënderajt është i organizuar dhe funksionon në tri nivele:

²⁷ Marrë nga <https://kk.rks-gov.net/skenderaj/qyteti/pozita-gjeografike/> Qasur [më 10.02.2021].

- arsimin parashkollor,
- arsimin fillor
- arsimin e mesëm.

Në Skënderaj funksionon një çerdhe për fëmijë me kapacitet prej 75 fëmijë, me qëndrim ditor dhe kujdesin me edukimin e fëmijëve e realizojnë 11 edukatore. (Publikimi vjetor i Statistikave të Arsimit ne Kosove për vitin shkollor 2019/2020, 2020)

Arsimin parfillor ky nivel i arsimit përfshihen fëmijët e moshës $5 < 6$ dhe është i organizuar në çerdhe dhe objektet e shkollave fillore dhe fillore të mesme të ulëta me gjithsej 663 nxënës (Publikimi vjetor i Statistikave të Arsimit ne Kosove për vitin shkollor 2019/2020, 2020)

Arsimi fillor zhvillohet në 22 shkolla fillore dhe në 12 paralele të ndara fizike me gjithsej 6809 nxënës, dhe procesin edukativo-arsimor e zhvillojnë 500 punëtorë arsimorë. (Publikimi vjetor i Statistikave të Arsimit ne Kosove për vitin shkollor 2019/2020, 2020)

Arsimi i mesëm në qytetin e Skënderajt zhvillohet në katër shkolla të mesme. Në gjimnazin e qytetit në shkollën teknike dhe në shkollën profesionale me gjithsej 2228 nxënës. Dhe procesin edukativo-arsimor e zhvillojnë 153 punëtorë arsimorë (Publikimi vjetor i Statistikave të Arsimit ne Kosove për vitin shkollor 2019/2020, 2020)

Numri i nxënësve i përfshirë në shkollim me tri nivelet në komunën e Skënderajt është 9775 nxënës, ku janë të përfshirë 664 mesimdhenës në të gjitha nivelet e arsimit (Publikimi vjetor i Statistikave të Arsimit ne Kosove për vitin shkollor 2019/2020, 2020)

Numri i nxënësve me nevoja të veçanta të përfshirë në Kosovë është 3903 nxënës (mungojnë statistika të ndara në komuna por vetëm janë të përfshirë si tërsi) nga gjithsej nxënës me nevoja të veçanta 171 nxënës janë të përfshirë me sindromën Daun në të gjitha institucionet arsimore në Kosovë. (Publikimi vjetor i Statistikave të Arsimit ne Kosove për vitin shkollor 2019/2020, 2020)²⁸

5.3 Institucioni parashkollor “Nëna Zahide” - Skënderaj

Në Skënderaj është vetëm kjo çerdhe shtetërore. Në këtë çerdhe janë të përfshirë nxënësit e rregullt dhe planprogrami është i njëjtë si në të gjitha çerddhet e tjera shtetërore. Sa i përket gjithëpërfshirjes së nxënësve me sindromën Daun nuk është i përfshirë asnjë nxënës. Sa i përket mundësi se regjistrimit të nxënësve me sindromën Daun në këtë çerdhe mungon edhe informacioni për prindërit. Shpeshherë prindërit nuk e dinë se në këtë çerdhe mund t'i regjistrojnë edhe fëmijët e tyre qoftë me sindromën Daun qoftë edhe me nevoja të tjera të veçanta.

²⁸ Të dhënat e nxënësve me nevoja të veçanta dhe saktësia e këtyre të dhënave është komplekse për faktin që akoma nuk janë vlerësuar të gjithë nxënësit me nevoja të veçanta që janë në klasat e rregullta nga ekipet vlerësuese profesionale në komuna.

Politikat e arsimit janë duke e përkrahur gjithëpërfshirjen edhe në çerdhet e rregullta. Sa i përket mungesës së gjithëpërfshirjes së nxënësve me sindromën Daun në këtë çerdhe është mungesa e informacionit nga vetë zyrtarët e çerdhes dhe personat kompetentë.

Vetëdijesimi i shoqërisë e sidomos i prindërve që kanë fëmijë me sindromën Daun është i nevojshëm për një nivel më të lartë të gjithëpërfshirjes. Kur fëmijët bashkëveprojnë në mes vete në fëmijërinë e hershme, kjo do të rezultojë pozitivisht edhe në të ardhmen në zhdukjen e paragjykimeve dhe krijimin e një ambienti të pranuar dhe të hapur për të gjithë: si për nxënësit me sindromën Daun, për prindërit e tyre, pastaj edhe për fëmijët e rregullt dhe prindërit e tyre.

5.4 Gjithëpërfshirja e nxënësve me sindromën Daun në shkollat fillore në Skënderaj

Për fëmijë me sindromën Daun, aftësitë e kufizuara në të nxënë së pari bëhen të dukshme kur ata hyjnë në shkollë dhe dështojnë në përvetësimin e shkathtësive akademike. Dështimet shpesh paraqiten në lexim, por ato ndodhin edhe në matematikë, shkrim ose në lëndët e tjera shkollore. Ndër sjelljet më të shpeshta të evidencuara në vitet e para të shkollës fillore janë aftësia e kufizuar për të vijuar mësimin dhe për t'u përqëndruar; shkathtësitë e dobëta motorike, si në të mbajturit e lapsit dhe në shkrimin e dobët; dhe vështirësia në të nxënit e leximit.

Në vitet e mëvonshme të shkollës fillore, kur programi mësimor bëhet më i vështirë, problemet mund të bëhen më emergjente në fushat e tjera si në shkencat shoqërore ose ato natyrore. Problemet emocionale gjithashtu bëhen një pengesë pas dështimit të përsëritur disa vjeçare dhe nxënësit bëhen më të vetëdijshëm për arritjet e tyre të dobëta në krahasim me ato të bashkëmoshatarëve të tyre. Për disa nxënës, problemet sociale dhe pamundësia për të bërë dhe për të mbajtur shokët ka rëndësi të madhe në këtë nivel të moshës.

Shkollat në të cilat janë përfshirë nxënës me sindromën Daun në komunën e Skënderajt janë identifikuar gjithsej 8 (tetë): shkolla fillore “Shaban Jashari” dhe “Ahmet Delija” në Skënderaj, “Abedin Rexha” në Turiçec, “Shotë Galica” në Runik, “Dëshmorët e Qyqavicës” në Çirez, “Malush Ahmeti” në Rezallë, “Ismet Uka” në Ticë, “Enver Haliti” në Lubovec. Në disa nga këto shkolla nxënësit me sindromën Daun ndjekin mësim në klasat e bashkangjitura-speciale (klasa të dedikura vetëm për nxënësit me nevoja të veçanta që janë të përfshirë të gjitha kategoritë duke i përfshirë edhe nxënësit me sindromën Daun), e në disa prej shkollave janë përfshirë në klasat e rregullta.

5.5 Shkolla fillore “Abedin Rexha”

Sikurse në shkollat e tjera edhe në këtë shkollë në kuadër të së cilës gjendet klasa e bashkangjitur. Në këtë klasë gjithsej janë 4 nxënës, ku njëri prej tyre është me sindromën Daun.

5.6 Shkolla fillore “Malush Ahmeti”

Në këtë shkollë është edhe klasa e bashkangjitur në të cilën e ndjekin mësimin gjithsej 6 nxënës, prej tyre 4 meshkuj dhe 2 femra, ku katër prej tyre janë me sindromën Daun, një vajzë dhe tre meshkuj, ku edhe këta nxënës e ndjekin mësimin në klasë të bashkangjitur.

5.7 Shkolla fillore “Ahmet Delija” dhe shkolla fillore “Shaban Jashari”

Edhe në këto dy shkolla fillore janë duke ndjekur mësim nxënës me sindromën Daun, por numri i tyre është më i madh se në shkollat e tjera të lartpërmendura, vlen të ceket se këto dy shkolla janë në brendësi të qytetit të Skënderajt dhe si duket prindërit janë më të informuar rreth mundësisë së arsimimit të fëmijëve të tyre, gjithashtu edhe afërsia e shkollës luan një rol shumë të rëndësishëm, pasi që e dimi që fëmijët me sindromën Daun nuk janë gjithmonë të pavrur që të udhëtojnë vetëm, gjithashtu mungon edhe transporti për këta fëmijë, Në shkollën “Ahmet Delija” janë gjithsej 12 nxënës me nevoja të veçanta, ku njëri ndër ta është me sindromën Daun. Në këtë shkollë nxënësi me sindromën Daun është i integruar në klasë të rregullt. Mësimdhënësit që punojnë me këtë nxënës theksojnë se përpiqen që t’ia thjeshtësojnë njësitë mësimore për këtë nxënës dhe t’i përshtaten nevojave të tij.

Shkolla fillore “Shaban Jashari” ka traditë më të hershme sa i përket trajtimit të nxënësve me nevoja të veçanta. Në kuadër të kësaj shkolle kanë funksionuar dy klasë të bashkangjitura, por me kalimin e kohës njëra klasë është shuar dhe tash funksionon vetëm një klasë e bashkangjitur me gjithsej 9 nxënës. Ku tre prej tyre janë me sindromën Daun.

5.8 Shkolla fillore “Ismet Uka” Ticë

Në këtë shkolle është identifikuar një nxënës me sindromën Daun i cili është integruar në klasë të rregullt, dhe vijon klasën e 4-të me bashkëmoshatarët e vet. Mësimdhënësit që punonjnë në këtë klasë në mungesë të mësimdhënësit ndihmës janë të detyrar që të ndihmojnë dhe ta përcjellin punën e tij

5.9 Shkolla fillore “Enver Haliti” Lubovec

Në këtë shkollë është identifikuar një nxënës me sindromën Daun i cili është integruar në klasë të rregullt, dhe vijon klasën e 2 me bashkëmoshatarët e tij, mësimdhënësit që punonjnë në këtë klasë në mungesë të mësimdhënësit ndihmës janë të detyrar që ta ndihmojnë dhe ta përcjellin punën e tij, që në shumë raste mbeten anash nxënësit e tjerë.

5.9 Shkolla fillore “Dëshmorët e Qyqavicës” Çirez

Në këtë shkollë është identifikuar një nxënës me sindromën Daun i cili herë pas herë vijon mësimin në klasë të bashkangjitur, po sipas stafit mësimi i këtij fëmije nuk është i rregullt.

Nr	Shkollat	Vendi	Numri i nxënësve me sindromën Daun	Mënyra e integritimit në klasë
1	“Shaban Jashari ”	Skënderaj	3	në klasë të veçanta
2	“Ahmet Delija”	Skënderaj	1	në klasë të veçanta
3	“Abedin Rexha”	Turiçec	1	në klasë të veçanta
4	“Shotë Galica”	Runik	0	
5	“Dëshmorët e Qyqavicës”	Çirez	1	në klasë të veçanta
6	“Malush Ahmeti”	Rezallë	4	në klasë të veçanta
7	“Ismet Uka”	Ticë	1	në klasë të rregullt
8	“Enver Haliti”	Lubovec	1	në klasë të rregullt
Gjithsej nxënës me sindromën Daun			12	

Tabela 1. Përfshirja e nxënësve me sindromën Daun në shkollat e Skënderajt

5.10 Gjithëpërfshirja e nxënësve me sindromën Daun në shkollat e mesme në Skënderaj

Ndryshimet rrënjësore në shkollë paraqiten në nivelin e shkollës së mesme dhe adoleshentët kuptojnë që me aftësinë e kufizuar në të nxënë ata fillojnë të humbasin shumë. Kërkesat më të vështira të programit dhe të mësuesve të shkollës së mesme të ulët dhe asaj të lartë, trazirat dhe dështimi i vazhdueshëm së bashku e thellojnë vështirësinë në të nxënë. Adoleshentët po ashtu janë të shqetësuar për jetën pas përfundimit të shkollës. Atyre mund t’u duhet këshillimi dhe udhëzimi për fakultet, karrierë dhe marrjen e vendimeve për profesionin që do ta zgjedhin. Për të keqësuar më tepër këtë situatë, disa adoleshentë e gjejnë veten të lëshuar në veprimet e delikuencës së të miturve. Pasi që adoleshentët kanë prirje të jenë tej mase të ndjeshëm shpesh disa probleme emocionale, sociale dhe formimi i konceptit për vetveten e shoqërojnë aftësinë e kufizuar në të nxënë në këtë moshë. Rreth 59 % e të gjithë fëmijëve me aftësi të kufizuara në të nxënë janë në grupmoshat 12-21 vjeç. (Linda Salihu, 2009)

Sa i përket gjendjes së nxënësve me sindromën Daun në Skënderaj, në shkollën e mesme niveli i integritetit të këtyre fëmijëve është **zero**. Kjo është si pasojë e mundësive të vogla që ofrojnë shkollat e mesme. Praktikisht ka raste kur nxënësi me sindromën Daun është regjistruar në shkollën e mesme teknike por vijimi i tij në shkollë nuk ndodh asnjëherë. Arsyt e mos vijueshmërisë janë edhe faktorët e cekur më lart. Miratimi i programeve të përshtatshme për këta nxënës dhe angazhimi më i madh në integrimin e tyre do të rriste numrin e nxënësve që do ta vijonin mësimin në këto shkolla, e sidomos kur nxënësit kanë dëmtime më të lehta. Gjithashtu, mundësi më e mirë për këta nxënës janë shkollat profesionale

5.11 Transporti për fëmijët me sindromën Daun në komunën e Skënderajt

Sipas ligjit mbi arsimin fillor dhe të mesëm komuna është përgjegjëse për organizimin e transportit për këta fëmijë. Kjo me të vërtetë është një situatë mjaft e vështirë duke pasur parasysh fëmijët me vështërsi në ecje apo karroca, të cilët nuk mund të udhëtojnë në një distancë mjaft të madhe edhe nëse ata janë të përkrahur nga familja dhe shoqëria. Meqenëse nuk ekziston asnjë shërbim zyrtar që ofron transportin deri te shkolla për këta fëmijë edhe në pamundësi që të sigurohet nga minibusi për secilën komunë (për shkak se kjo mënyrë e organizimit të transportit është mjaft e shtrenjtë).

Për transportin e fëmijëve sindromën Daun dhe fëmijëve të tjerë me nevojë të veçantë brenda komunës së Skënderajt, përgjegjësia ka qenë dhe ende mbetet nga Ministria e Arsimit e komunës së Skënderajt. Sa i përket transportit të kësaj komune nuk qëndron edhe mirë, pasi që të gjithë fëmijët me sindromën Daun dhe fëmijët të tjerë me nevojë të veçantë u mungon transporti në të gjitha shkollat që i cekëm më lart.

KAPITULLI VI

METODOLOGJIA E HULUMTIMIT

6.1 Metodologjia

Mjet kryesor i mbledhjes së të dhënave në këtë hulumtim ka qenë anketa e cila është bazuar kryesisht në pyetësin konstruktiv. Lidhur me çështjen që trajtojmë kemi përzgjedhur si instrument anketën e cila është një nga metodat kuantitative të grumbullimit të të dhënave lidhur me dukurinë që hulumtohet, andaj është zgjedhur një metodë e tillë për të siguruar të dhëna kualitative që ndihmojnë në informim dhe vetëdijesim të rëndësisë së edukimit të nxënësve me sindromën Daun.

Hulumtimi është realizuar në tre target grupe:

- Me prindërit e nxënësve me sindromën Daun;
- Me mësimdhënësit që punojnë me nxënës me sindromën Daun, në klasë të bashkangjitura;
- Më mësimdhënësit e rregullt, por që kanë të integruar brenda klasës së tyre nxënës me sindromën Daun.

Alternativë tjetër studiuëse, është përdorur edhe studimi i të dhënave arkivore. Kemi menduar se krahasimi i të dhënave do ta kompletonte punimin dhe studimin tonë por fatkeqësisht nuk kemi gjetur ndonjë studim të mirëfilltë kuantitativ rreth kësaj çështje që po e trajtojmë. Urojmë që ky hulumtim do të ndihmojë edhe më shumë partnerët dhe institucionet relevante që të shfrytëzojnë të dhënat për të zhvilluar më pas strategji të reja për nxënësit me sindromën Daun, duke marrë diçka edhe nga ato strategji që janë treguar efikase në vendet e tjera.

Hulumtimi është aplikuar në komunën e Skënderaj, me një mostër prej 32 respondentëve, nga kjo anketë kemi kuptuar përfshirjen e nxënësve me sindromën Daun në shkollat e Skënderajt.

Të përfshirë në këtë studim janë vetëm nxënësit me sindromën Daun të shkollave fillore, pasi që në shkollat e mesme e që janë tri në komunën e Skënderjat nuk ka nxënës me sindromën Daun. Të dhënat janë analizuar me programe për hulumtime.

6.2 Popullacioni dhe mostra

Nga analizat e bëra në komunën e Skënderajt, kuptuam se numri i nxënësve me sindromën Daun që ndjekin mësim në shkollat e Skënderaj është 12, numri i mësuesve specialë është 6.

Duke u bazuar në ndjeshmërinë e hulumtimit dhe gjendjen e vështirë shëndetësore të disa nxënësve të cilët kohë pas kohe nuk mund të jenë ndjekës të rregullt të mësimi. Gjithashtu, duke u bazuar në numrin modest të personave të cilët pretendojmë t'i anketojmë, e po ashtu edhe mundësinë që disa pyetësor të jenë të pavlefshëm, përzgjedhja e mostrës u bë në atë mënyrë që të provojmë të anketojmë çdo prind që ka fëmijë me sindromën Daun duke ndjekur mësim dhe të gjithë mësimdhënësit që punojnë me këta fëmijë, atëherë kjo kalon edhe parashikimet për një hulumtim cilësor dhe sasior.

Gjithashtu dëshirojmë të theksojmë se pyetësi përgjithësisht ka përmbajtur pyetje të tipit të mbyllur, me alternativa në përgjigje. Mirëpo nuk kanë munguar edhe pyetjet kualitative. Në këtë nivel, jemi përpjekur që t'iu shmangemi pyetjeve sugjестive dhe njëherazi edhe pyetjeve të dyfishta. Gjithashtu, gjatë konstruktimit janë marrë parasysh dhe janë shënuar të gjitha të dhënat individuale me interes përfshirë të dhënat demografike, të cilat kanë shërbyer si variabla të pavarura në këtë hulumtim. Duke njohur përparësitë e pyetësorit, aspektin ekonomik dhe mundësinë e jashtëzakonshme të manipulimit profesional me variablat, në këtë studim kemi zgjedhur pyetësorin si instrumentin kryesor të mbledhjes së të dhënave, por jo edhe të vetmin.

Besojmë se një formë e tillë dhe aplikimi i përzgjedhjes së mostrës së rastësishme ka shtuar validitetin dhe sigurinë e të dhënave të fituara. Për të marrë informacion më të thelluar për çështjet që u evidentuan si të rëndësishme nga të dhënat e përfituara nga pyetësorët sasiorë, u organizuan fokus grupe me pjesëmarrjen e personave prej të cilëve: prindër të fëmijëve me sindromën Daun dhe mësimdhënësit. Pjesëmarrësit morën pjesë vullnetarisht në plotësimin e pyetësorëve.

6.3 Procedura për realizimin e hulumtimit

Për realizimin efektiv të hulumtimit duhej edhe koordinimi me përfaqësues nga Drejtoria Komonale e Arsimit në Skënderaj, përfaqësuesit e shkollave, mësuesit dhe nxënësit (posaçërisht prindërit e nxënësve me sindromën Daun).

Fillimisht iu drejtova me një kërkesë DKA-së në Skënderaj, kërkesa më ndihmoi që të marr miratimin zyrtar nga Drejtoria që të mund ta zhvilloj hulumtimin në fjalë. Të qartësuara ishin qëllimet e mia për mënyrën e hulumtimit dhe target-grupet prej të cilave do të grumbullohej informacioni. DKA-ja në Skënderaj pranoi të ishte një ndër lehtësuesit e këtij studimi. Pastaj në bashkëpunim më zyrtar kompetent identifikua shkollat ku do të zhvillohej studimi, si dhe u krijua mundësia e një takimi edhe me drejtuesit e shkollave. Duhet cekur se hulumtimi u realizua në 8 shkolla fillore në të cilat ndjekin

mësim nxënës me sindromën Daun dhe në shumicën e këtyre shkollave ishin funksionale edhe klasë të bashkangjitura, pjesë e hulumtimit ishte edhe qendra private “Florjani” për nxënës parashkollor.

Në takimin me drejtuesit e shkollave u zhvillua e njëjta praktikë. Ata u njoftuan me qëllimin e studimit dhe me atë se çfarë do të arrihej prej tij. Këta drejtues do të shërbenin si lehtësues për identifikimin e grupit të mësuesve, i cili do të përzgjidhej më pas për plotësimin e pyetësorëve sasiore, si dhe të atyre që do të ishin pjesë e fokus-grupit për mësuesit. Gjithashtu në bashkëpunim më zyrtarët apo mësuesen speciale të shkollës, identifikuam nxënësit me sindromën Daun, prindërit e të cilëve do të plotësonin pyetësorin, pasi që ata ishin një ndër target-grupet e rëndësishme për realizimin e studimit.

E njëjta procedurë vazhdoi edhe më mësuesit. Ky fokus-grup u thirr në një kohë të përshtatshme, jashtë orarit të mësimi. Gjithashtu një takim zhvilluam edhe më përfaqësuesen e qendresë private “Florjani” në Skënderaj, nga e cila morëm qëndrim pozitiv për bashkëpunim në hulumtimin shkencor.

Pas një periudhe 20 ditore, mbaroi realizimi i punës në terren dhe të dhënat ishin anonime dhe u ruajtën në mënyrë konfidenciale.

6.4 Analiza e të dhënave

Analiza e të dhënave është kryer me anë të programit statistikor. Për secilin target-grup të pjesëmarrësve në plotësimin e pyetësorit, të dhënat u regjistruan.

Duke u mbështetur edhe në natyrën dhe qëllimin e hulumtimit, analiza është kryesisht deskriptive dhe synon të japë një raport të qartë të gjendjes faktike në terren.

Koha e mbledhjes së të dhënave ishin në muajin Mars, ndërsa sistemimi i të dhënave u bë në muajin Prill-Maj të vitit 2021. Gjithashtu, etika profesionale ka qënë ajo që na ka ndjekur në të gjitha fazat e punimit, si në administrim, futje të të dhënave dhe në përpunimin dhe analizën e tyre.

Studimi synoi të vlerësojë zbatimin e modelit të gjithëpërfshirjes së nxënësve me sindromën Daun në shkollat e Skënderajt.

6.5 Etika e studimit

Duhet cekur se përveç tjerash një hulumtim i mirëfilltë duhet t’i përmbahet edhe etikës së lartë profesionale. Gjatë realizimit të këtij hulumtimi respektuam rregullat etike në çdo aspekt, e posaçërisht vëmendje e veçantë i është kushtuar edhe sqarimeve, rregullave dhe sigurimin se pyetësori është anonim dhe që të dhënat janë konfidenciale.

Pjesëmarrësit morën pjesë vullnetarisht në plotësimin e pyetësorëve. Ata nuk u identifikuan gjatë procesit të plotësimit të pyetësorëve. Që në fillim sqaruam se ata mund të shprehin lirshëm mendimin e tyre.

Në pjesën e sipërme të secilit pyetësor u jepen shpjegime për qëllimin e studimit dhe përse do të shërbejnë të dhënat e mbledhura, udhëzime në mënyrën e plotësimit të pyetësorit. Të dhënat në studim u paraqitën të përmbledhura dhe nuk japin informacion të hollësishëm për identitetin e pjesëmarrësve dhe institucioneve.

6.6 Pyetësi

Në këtë hulumtim janë krijuar dy pyetësorë të pavarur nga njëri-tjetri. Objektivat e pyetësorit të parë të dizajnuar për këtë hulumtim janë të fokusuara në hulumtimin se sa e përdorin nxënësit me sindromen Daun teknologjin informative në procesin mësimor. Pyetësi është dizajnuar elektronikisht dhe është shpërndarë përmes email-it dhe rrjeteve sociale. Kriteri për përzgjedhjen e pjesëmarrësve ka qenë që pjesëmarrësit të jenë mësimdhënës të shkollave të komunës së Skënderajt që kanë punuar dhe që punojnë me nxënësit me sindromën Daun.

Ndërsa pyetësi i dytë i dizajnuar për këtë hulumtim ka për fokus prindërit e nxënësve me sindromën Daun.

KAPITULLI VII

ANALIZA, PARAQITJA DHE INTERPRETIMI I REZULTATEVE TË HULUMTIMIT

7.1 Analiza e të dhënave nga pyetësi


Pas një punë të gjatë, pyetësorët janë analizuar duke përdorur një qasje tematike të analizave për të siguruar besueshmëri në të dhënat të cilat janë nxjerrë nga hulumtimi. Për t'i analizuar si duhet të dhënat, janë përdorur metoda statistikore, pra gjetjet e rezultateve që kemi paraqitur përmes grafikeve.

Pjesë e këtij hulumtimi ishin mësimdhënësit dhe prindërit e nxënësve me sindromën Daun, ku 20 nga ta ishin mësimdhënësit dhe 12 ishin prindër të nxënësve me sindromën Daun. Duke u nisur nga fakti që hulumtimi është pak sa i veçantë dhe i koncentruar vetëm në një qytet, pra në Skënderja për këtë çështje numri që kemi mujtur ta identifikojmë nuk ka qenë më i madhe.



Graf. 1. Pjesëmarrësit në hulumtim

Nga 32 respondentët e anketuar, 20 prej tyre ishin mësimdhënësit që punojnë ose që kanë punuar me nxënës me sindromën Daun, kurse 12 prej tyre ishin prindër, apo shprehur në gjuhën e përqindjeve 62 % e respondentëve ishin mësimdhënësit dhe 38 % e respondentëve ishin prindër të fëmijëve me sindromën Daun.



Graf .2. Grupimet e mësimdhënësve pjesëmarrësve në hulumtim

Siç shihet në figurën e mësipërme kemi bërë një laramani të mësimdhënësve në hulumtim, prej tyre i kemi përfshirë të gjitha kategoritë e mësimdhënësve që punojnë me nxënës me sindromën Daun. Një grup prej tyre përbënin mësuesit specialë që punojnë në klasat bashkangjitime, grupi tjetër ishin mësimdhënës gjithpërfshirës, që fatkeqësisht është një numër mjaft i vogël në shkollat e Skënderajt, dhe grupi i tretë përfshin mësimdhënësit e rregullt por që në klasat e tyre ku japin mësim këta mësues, janë të integruar edhe nxënës me nevoja të veçanta.

7.2 Rezultatet nga pjesa e parë e pyetësorit

Në pyetësor janë të përfshirë të gjithë ata mësimdhënës që kanë punuar dhe që janë duke punuar me fëmijët me sindromën Daun në të gjitha shkollat e Skënderajt, si dhe në të gjitha nivelet e arsimit, siç shihet edhe nga tabela përqendrimi ka qenë shumë më i madh në arsimin fillore me gjethej 13 mësimdhënës apo shprehur në përqindje 65%, për arsye se në arsimin fillore ka më shumë nxënës të përfshirë në procesin mësimor, ndërsa 15% e të intervistuarve ka qenë në arsimin e mesëm, kurse në arsimin para fillor kanë qenë 20%. Sa i përket përvojës së mësimdhënësve në procesin mësimor dominon përvoja nga 7 deri 10 vite që është 35% . Mësimdhënësit e shohin si shumë të rëndësishme informimin rreth sindromës Daun ku 90% janë përgjigjur që është shumë i rëndësishëm informimi rreth sindromës Daun.

Në pyetjen e parshtruar se çka do të ndryshonit po të kishit mundësi në institucionin ku ju punoni për fëmijët me sindromën Daun, sipas përgjigjeve të mësimdhënësve nga të gjithë të anketuarit


ku 55% janë përgjegjur për **Integrimin në shkolla të rregullta** kurse me 45% janë përgjegjur **Përmirësimin e kushteve të punës**.

Pyetjet	Përgjigjet me frekuencë me të lart/ nëngrupi i përgjigjeve	Nga 20, pyetësor	
		Nr.	%
Në cilin nivel të procesit mësimor jeni duke punuar?	Në arsimin parashkollor	4	20%
	Në arsimin fillor	13	65%
	Në arsimin e mesëm	3	15%
Sa keni përvojë në mësimdhënie?	1—3	3	15%
	4—7	5	25%
	7—10	7	35%
	Më shumë se 10 vite	5	25%
Sa është me rëndësi të informoheni rreth sindromës Daun?	Shumë	18	90%
	Deri diku	1	5%
	Pak	1	5%
	Aspak	0	0%
Sipas mendimit tuaj sa janë të rëndësishëm për ju dhe institucionin ku punoni, trajnimet rreth njohurive për nxënësit me sindromën Daun?	Shumë të rëndësishme	14	70%
	Të rëndësishme	5	25%
	Pak të rëndësishme	1	5%
Çka do të ndryshonit po të kishit mundësi në institucionin ku ju punoni për fëmijët me sindromën Daun?	Përmirësimin e kushteve të punës	9	45%
	Integrimin në shkolla të rregullta	11	55%
Çfarë janë pritjet tuaja në përgjithësi për ndryshimet që mund të bëhen në dobi të fëmijëve me sindromën Daun për një të ardhme të afërt?	Implementimi i ligjeve për arsimin gjithëpërfshirës	16	80%
	Investimet në shëndetësi, në arsim dhe në çështje sociale	4	20%

Tabela 2. Përgjigjet me frekuencë më të lart/ nëngrupi i përgjigjeve

7.3 Përvoja e mësimeve kur kanë hasur për herë të parë me nxënës me sindromën Daun


Sipas rezultateve të nxjerra nga pyetësi me mësimeve, shihet që 12 mësimeve apo 60% janë përgjigjur që përvoja e tyre ka qenë e mirë, kurse me 40% apo 8 nga mësimeve janë përgjigjur që kur kanë hasur për herë të parë me fëmijët me sindromën Daun kanë pasur përvojë shumë të mirë, që vlen të theksot se asnjëri nga mësimeve nuk ka pasur ndonjë përvojë të keqe.



Graf.3. Përvoja e mësimeve me nxënës me sindromën Daun

7.4 A janë të diskriminuar fëmijët me sindromën Daun në ambientet e shkollës sipas mësimeve

Grafiku më poshtë tregon që 60% e mësimeve apo 12 nga ta kanë dëgjuar raste që ka pasur diskriminim në ambientet e shkollës që është një përqindje tejte shqetësues ku del që edhe 3 nga mësimeve apo 15% kanë informacion që nxënës me sindromën Daun janë të diskriminuar edhe nga bashkëmoshatarët e tyre në shkollë, kurse 5 mësimeve apo 25% janë përgjigjur që nuk ka diskriminim në ambientet shkollore. Nga rezultatet e nxjerra del që nxënës me sindromën Daun nuk janë të diskriminuar nga mësimeve.



Graf. 4. Diskriminim i fëmijëve me sindomën Daun në ambientet e shkollës sipas mësimmshënësve

7.5 Si pranohen nxënësit me sindromën Daun nga nxënësit e tjerë në klasë apo në shkollë

Nga grafiku i mëposhtëm mësimmshënësit janë deklaruar me një përqindje prej 65% që nxënësit me sindromën Daun pranohen mirë nga bashkëmoshatarët e tyre në ambientet shkollre, kurse 30% kanë deklaruar që nuk pranohen aspak mirë në ambientet shkollre kurse vetëm 5% kanë deklaruar që janë pranuar shumë mirë në ambientet shkollre apo edhe në klasë.



Graf. 5. A pranohen nxënësit me SD nga nxënësit e tjerë në shkollë

7.6 Shoqërimi nxënësve të tjerë me nxënësit me sindromën Daun

Për ta kuptuar se si qëndron shoqërimi i nxënësve të tjerë në ambientet e shkollës me nxënësit me sindromën Daun nga këndvështirm i mësimitdhënësve të gjithë mësimitdhënësit e përzgjedhur dhanë mendimin e tyre vetëm me Po dhe Jo, ku nga ta janë përgjigjur me 40% që shoqërohen apo 8 nga mësimitdhënësit kurse me 60% apo 12 nga mësimitdhënësit kanë thenë që nxënësit që janë në klasë apo në ambiente shkollore me një nxënës me sindromën Daun nuk shoqërohen me ta.



Graf. 6. Shoqërim i nxënësve të tjerë me nxënësit me sindromën Daun?

7.7 A janë nxënësit me sindromën Daun agresivë apo kanë pasur konflikt me nxënësit e tjerë


Sipas rezultateve të nxjerra nga pyetësi me mësimitdhënës, shihet që me 85% apo 17 nga mësimitdhënësit janë përgjigjur që nxënësit me sindromën Daun nuk kanë qenë agresivë apo nuk kanë pasur ndonjë konflikt me nxënësit e tjerë, ku nga kjo mund të kuptojmë që fëmijët (nxënësit) me sindromën Daun nuk shprehin agresivitet apo konflikt ndaj bashkëmoshatarëve e tyre, kurse me 15% apo 3 nga mësimitdhënësit janë përgjigjur që kanë pasur agresivitet apo konflikt me nxënësit e tjerë.



Graf. 7. A janë nxënësit me sindromën Daun agresivë apo kanë pasur konflikt me nxënësit e tjerë?

7.8 Vështirësi që janë hasur në mësimdhënie tek nxënësit me sindromën Daun


Siç shihet edhe nga grafiku i mëposhtëm nuk është që ka ndonjë vështirësi që mund të theksohet ku 25% janë përgjigjur që kanë nevojë për më shumë shpjegime, me 30% apo 6 nga kanë thënë që nuk arrijnë të pranojnë informatën shumë shpejt, me 45% apo 9 nga mësimdhënësit kanë thënë që kanë mungesë përqendrimi në orën mësimore.



Graf. 8. Paraqitja e vështirësive që kanë hasur mësimdhënësit, në mësimdhënie tek nxënësit me sindromën Daun

7.9 A parasheh kurrikula që të përdoret TIK-u në procesin mësimor për fëmijët me sindromën Daun


Diagrami më poshtë shfaq se sa janë kurrikulat të lidhura me TIK-un dhe çka parashihet në kurrikula lidhur me përdorimin e TIK-ut në mësimdhënie me nxënës me sindromën Daun, sipas mësimdhënësve që janë përgjigjur me 80% apo 16 nga ta kanë deklaruar që nuk është e specifikuar (nuk e kanë hasur) që duhet të përdoret TIK-u me nxënës me sindromën Daun, ndërsa me 20% kanë deklaruar me po, e përsëri që të ketë korrelacion (lidhje) me lëndën, TIK. Nga këtu shihet që edhe në kurrikula nuk është e specifikuar që të përdoret TIK-u me nxënës me sindromën Daun kur e dimë që përparësi e nxënësve me sindromën Daun është të kuptuarit vizual pra nëpërmjet figurave apo edhe me ilustrim të ndryshme qofshin ato video apo fotografi.



Graf. 9. Si e parasheh kurrikula që të përdoret TIK-u në procesin mësimor për fëmijët me sindromën Daun

7.10 A posedojnë shkollat kabinet të TIK-ut ku zhvillohet mësimi me nxënës me sindromën Daun


Siç është cekur edhe më lart nxënës me sindromën Daun përparësi për mësimdhënie e kanë të pamurit vizual gjë që e ofrohet në mënyra të përkryer nga TIK-u, duke e parë këtë përparësi, është e domosdoshme që në klasat ku punohet me nxënës me sindromën Daun të ketë edhe mundësi të pamjes vizual qoftë kompjuter, qoftë TV, nga marrje e rezultateve me mësimdhënës del që shkollat nuk qëndrojnë aq keq në këtë aspekt ku me 25% janë përgjigjur që po, kemi kabinetin me të gjitha pajisjet, me 50% kanë thënë po, kemi vetëm PC dhe projektor, ndërsa me 25% janë deklaruar që nuk ka kushte në shkollë për kabinet.



Graf. 10. A janë të paisur shkollat me kabinet të TIK-ut në klasë që ka nxënës me sindromën Daun

7.11 Sa përdoret TIK-u për mësimdhënie nga mësimdhënësit me nxënës me sindromën Daun?


Nga grafiku i mëposhtëm shihet që mësimdhënësit janë përgjigjur me 5% apo vetëm një mësimdhënës e përdor TIK-un rregullisht, me 75% janë përgjigjur që e përdorin TIK-un nganjëherë, ndërsa 20% e tyre janë shprehur që nuk e përdorin TIK-un me nxënësit me sindromën Daun për mësimdhënie.



Graf.11.Përdorni TIK-ut për mësimdhënie me nxënës me sindromën Daun

7.12 Pajisjet teknologjike që përdorin mësime dhënësit më së shpeshti

Pajisjet që i përdorin mësime dhënësit më së shpeshti e që janë nxjerrë nga pyetësi me mësime dhënësit del të jetë kompjuteri dhe projektor me 80%, me 15% TV kurse vetëm me 5% SmartPhone.



Graf. 12. Pajisja teknologjike që përdorni mësime dhënësit më shpesh?


7.13 Përqendrim i nxënësve me sindromën Daun kur kanë përdorur TIK-un në mësime

Sipas rezultateve të nxjerra nga pyetësi me mësime dhënësit, del që me 70% e mësime dhënësit janë përgjigjur po ka pasur përqendrim dhe kureshtje kur e kanë përdorur TIK-un ndërsa me 30% janë shprehur që Jo, s'kemi vërejtur përqendrimi apo intresim më të madhe kur është përdorur TIK-u



Graf. 13. Përqendrimi i nxënësve me sindromën Daun në përdorimin e TIK-ut


Në grafikun e mëposhtëm janë paraqitur rezultate të marra nga pyetja e parashtruara se a keni njohuri që ka softuer special për nxënësit me sindromën Duan, del që të gjithë mësimehdhënësit që janë përgjigjur në këtë pyetje nuk kanë njohuri që ka softuer special për nxënësit me sindromën Daun.



Graf. 14. Njohuritë rreth softuerëve për nxënësit me sindromën Daun


7.14 A përdoret TIK-u nga nxënësit me sindromën Daun për mësimehdhënë

Në grafikun e mëposhtëm janë paraqitur rezultatet e marra nga pyetësori për mësimehdhënës, ku ju është parshtruar pyetja a përdorin TIK-un nxënësit me sindromën Daun për mësimehdhënë me 65% janë përgjigjur kanë ngecje në përdorim të TIK-ut, me 35% janë përgjigjur që jo, nuk e përdorin, vërehet edhe nga mësimehdhënësit që fëmijët me sindromën Daun kanë ngecje në përdorimin e TIK-ut.



Graf. 15. Përdorimi i TIK-ut për mësimehdhënë nga nxënësit me sindromën Daun


Grafiku i mëposhtëm tregon cilët janë softuerët që i përdorin nxënësit me sindromën Daun sipas mësimdhënësve del që me 50% është softueri Paint, 30% janë përgjigjur që përdorin softuer të tjerë që nuk i kanë specifikuar, 10% Word gjithashtue me 10% është PowerPoint



Graf. 16. Softueri që përdorin nxënësit me sindromën Daun


7.15 Rezultatet nga pyetësi për prindërit e nxënësve (fëmijëve) me sindromën Daun

Pjesëmarrës në hulumtim janë edhe prindërit që kanë nxënës me sindromën Daun, në grafikun e mëposhtëm kemi paraqitur edhe përqindjet e nxënësve dhe formën e ndjekjes së mësimi në shkollë. Nxënës nga klasat e veçanta janë 83 %, ndërsa nxënës të integruar në klasë të rregullta janë 17 %. Në vazhdim do t'i paraqesim qëndrimet e prindërve lidhur me gjithëpërfshirjen e fëmijëve të tyre në shkollë sfidat që i kanë hasur për integrimin në shkollë teknologjia, aplikacionet, kohën që kalojnë para një paisjeje teknologjike, sfidat e që kanë lidhur me përdorimin e tyre.



Graf. 17. Forma e mësimi që ndjekin fëmijët me sindromën Daun

Sipas rezultateve të marra nga pyetësorët për prindër të fëmijëve me sindromën Daun mosha e fëmijëve del të jetë nga 6-10 vjeç 75%, ndërsa mosha nga 11-14 janë 25%, të gjithë prindërit janë deklaruar që fëmijët e tyre me sindromën Daun janë të integruar në procesin mësimor.




Graf. 18. Grupmoshat e përfshira në hulumtim

Në grafikun e mëposhtëm janë parqitur rezultatet e 12 prindërve pjesëmarrës në hulumtim. Të gjithë kanë dhënë qëndrimet e tyre lidhur me vështirësitë që kanë hasur për regjistrimin në shkollë. Ku me 75% janë përgjigjur që jo, nuk kemi pasur vështirësi për regjistrim në shkollë, me 25% apo 3 nga prindërit janë deklaruar që po, ka pasur hezitim nga personeli i shkollës



Graf. 19. Sfidat e regjistrimit të fëmijëve në shkollë

Kujdesi që ofrohet mbi informim, shkollimin, shëndetin, informacione nga komuna e Skënderajt ndaj fëmijëve me sindromën Daun, prindërit janë shprehur që ka përkrahje dhe ka interesim për këtë kategori të fëmijëve, por jo në nivelin e kënaqur ku me 66.7% janë deklaruar që nuk ofrojnë shërbime sa kanë nevojë, ndërsa 33.3% janë përgjigjur që po, ofrojnë shërbimet e duhura.




Graf. 20. Ofrimi i shërbimeve ndaj fëmijëve me sindromën Daun

Në vijimi do t'i paraqesim se si fëmijët me sindromën Daun janë të mirëpritur në aspektet shoqëror dhe sa janë të kënaqur familjarët dhe prindërit me sjelljen shoqërore apo socializmin e këtyre fëmijëve në ambiente të përbashkëta shoqërore, nga grafiku shihet se ende ka hezitime që këta fëmijë të integrohen në shoqëri ku me 58% apo 7 nga prindërit e fëmijëve me sindromën Daun janë përgjigjur “jo, nuk jam i/e kënaqur” me sjelljen e të tjerëve ndaj fëmijëve me sindromën Daun kurse me 42% janë deklaruar se janë të kënaqur vetëm “me rrethin familjar jam i/e kënaqur”




Graf. 21. Mendimet e prindërve ndaj sjelljeve e të tjerëve ndaj fëmijëve të tyre

Ndryshimet që do t'i bënin prindërit po të kishin mundësi në rrethin ku jetojnë për një ambient më të mirë për fëmijët e tyre. Shumica nga prindërit me 58% janë deklaruar që në shoqëri duhet të ketë vetëdijesim kolektiv, 25% janë përgjigjur që fëmijëve me sindromën Daun t'u krijohen ambiente më të përshtatshme në rrethin shoqëror, ndërsa me 17% janë deklaruar që të tjerët të kenë respekt për fëmijët me sindromën Daun.




Graf. 22. Ndryshimet shoqërore për të mirën e fëmijëve me sindromën Daun

Rastet që i kemi identifikuar të fëmijëve me sindromën Daun dhe kontaktet me prindërit e këtyre fëmijëve janë deklaruar se fëmija i tyre ndjek mësimet në shkollë gjithë që është një ecje përpara rreth integritetit në shkollë, kurse pyetja që iu është bërë prindërve në cilën metodë e ndjek mësimin fëmija juaj ku me 83% janë deklaruar se metodat e ndjekes është “Në klasë të dedikuar për nxënësit me nevoja të veçanta” (në shkollat e Kosovës në klasat e dedikuar për nxënësit me nevoja të veçanta ndjekin mësimin të gjitha këto kategori, ku mund të jenë me dëmtime në tru, sindroma Daun, kretinizmi (më shumë hyn në kuadër të dëmtimeve fizike), dëmtime në të folur, dëmtime në të dëgjuar, dëmtime në të pamur, belbëzim, nxënës me çrregullime në sjellje, çrregullime në të mbajturit në mend, çrregullime psikofizike, epilepsi), ndërsa 17% në klasë të rregullt, në nuk kemi hasur ndonjë nxënës që është duke ndjekur mësimin në shkollë speciale për nxënësit me sindromën Daun (qendra burimore).



Graf. 23. Mënyra e ndjekjes së mësimin


Siç shihet edhe nga grafiku i mëposhtëm vërehet që prindërit ballafaqohen me vështirësi për dërgimin e fëmijëve të tyre në shkollë ku njëra nga to është që shkollat janë shumë largë nga vendi ku qëndrojnë fëmijët me sindromën Daun, kur e dimë që edhe transporti mungon për këtë kategori të nxënësve e që u bie barrë prindërve për t'i dërguar në shkollë. Rreth 50% janë deklaruar që hasin në vështirësi për t'i dërguar fëmijët në shkollë, ku shkollë ka qenë larg dhe nuk ka pasur transport, diçka që është shqetësues e që vërehet sfida për prindërit është edhe ngacmimi i fëmijëve me sindromën Daun nga bashkëmoshatarët e tyre ku 34% si vëshetërsi kanë qenë sepse fëmija i tyre ka qenë i ngacmuar nga bashkëmoshatarët e tyre, kruse me 8% janë deklaruar që ka pasur hezitimi nga udhëheqja e shkollës që ta pranojnë fëmijë me sindromën Daun, ndërsa 8% nuk kanë pasur vështirësi.



Graf. 24. Vështirësitë e dërgimit në shkollë

7.16 Përdorimi i pajisjeve teknologjike nga fëmijët me sindromën Daun

Prindërit deklarohen se fëmijët e tyre që janë me sindromën Daun përdorin pajisjet teknologjike ku në pyetjen e bërë a i përdor fëmija juaj pajisjet teknologjike me 83% janë deklaruar po, i përdorin pajisjet teknologjike kruse me 17% apo 2 nga prindërit janë përgjigjur me jo, nuk i përdorin pajisjet teknologjike. Në pyetjen e bërë se cilat janë arsyet që nuk i përdorin pajisjet teknologjike përgjigjja e prindërve ka qenë se fëmijët i prishin shumë shpejt dhe s'kemi mundësi t'i rregullojmë më.




Graf. 25. A përdorin fëmijët me sindromën Daun pajisjet teknologjike



Graf. 26. Arsyet e mospërdorimit të pajisjes teknologjike

Koha që fëmijët me sindromën Daun qëndrojnë pranë pajisjeve teknologjike (telefona, tableta, kompjuterë) nuk është edhe e vogël, pra edhe këta fëmijë sikurse edhe bashkëmoshatarët e tyre nuk kanë mundur t'i bëjnë ballë kohës së gjatë pranë pajisjeve teknologjike p.sh., telefona, tableta,


kompjuterë ku koha që qëndrojnë pranë një pajisje të tillë me 70% e prindërve të këtyre fëmijëve janë deklarua që fëmija i tyre qëndron nga 4 – 7 orë ndërsa me 30% nga 0 – 3 orë



Grafi. 27.Koha e qëndrimit pranë një pajisje teknologjike (p.sh telefona, tableta, kompjuterë)


7.17 Fillimi i moshës kur një fëmijë nis ta përdor pajisjen teknologjike si pas prindërve

Prindërit që morën pjesë në këtë pyetësor u deklaruan se fëmija i tyre përdor pajisje teknologjike. 10 nga prindërit që më lart janë deklaruar se fëmija i tyre përdor një pajisje teknologjike p.sh. telefon, kompjuter, tabletë, treguan moshën kur fëmija i tyre ka filluar ta përdorë një pajisje teknologjike ku me 60% ishte moshë 18 muajshe-4 vjeç që është një kohë ku nisin të gjithë fëmijët të kenë qasje në një pajisje teknologjike kurse me 40% nga 5 deri 8 vjeç.




Grafi. 28.Moshë e përdorimit të pajisjeve teknologjike

Të gjithë prindërve iu parashtruar pyetja “Si mësoi fëmija juaj t’i përdorë pajisjet e teknologjisë inteligjente” ata dhanë këto përgjigje me 70% apo 7 nga prindërit u përgjigjën se fëmija i tyre merr udhëzime të drejtpërdrejta nga prindërit ose vëllezërit e motrat. 30% nga ta thanë që fëmija i tyre imiton, asnjëri nga prindërit nuk është përgjigjur që fëmija i tyre merr instruksion apo mëson në shkollë mbi përdorimin e pajisjeve teknologjike gjë që dëshmon se mësimdhënësit nuk u kushtojnë vëmendje në këtë aspekt.




Graf. 29. Nga kush marrin udhëzime fëmijët me sindromën Daun mbi përdorimin e pajisjeve të teknologjisë

Arsyeja e përdorimit të pajisjeve teknologjike nga këta janë me 80% kanë deklaruar që e përdorin për ta kënaqur kuriozitetin e tyre, me 20% për kohë të lirë / argëtimi, ndërsa asnjëri nga 10 prindërit e anketuar nuk janë deklaruar që këta fëmijë përdorin pajisjet teknologjike për arsimim apo edhe për komunikim.




Grafi. 30. Arsyeja e përdorimit të pajisjeve të teknologjisë

Grafikët në vazhdim na praquesin se a e përdorni TIK-un për mësimnxënie, për detyra të ndryshme që i jepen nga mësimdhënësit fëmijët me sindromën Daun. Të gjithë prindërit janë deklaruar që jo nuk e përdorin TIK-un për mësimnxënie fëmijët e tyre, gjithashtu prindërit nuk kanë as njohuri mbi ekzistimin e softuerëve specialë për fëmijët e tyre (fëmijët me sindromën Daun).



Graf. 31. A e përdorni TIK-un për mësimnxënie, për detyra të ndryshme që i jepen nga mësimdhënësit




Gafi. 32. A keni njohuri që ekzistojnë softuerë specialë për fëmijët me sindromën Daun për mësimnxënie

7.18 Sa shpesh i përdor pajisjet e mëposhtme teknologjike fëmija juaj


Për ta identifikuar se cilat janë pajisjet teknologjike që fëmijët me sindromën Daun i përdorin më së shumti dhe cila është koha që ata qëndrojnë pranë këtyre pajisjeve na tregoni grafiku i mëposhtëm, me 3 – 5 orë 7 nga prindërit janë deklaruar që fëmija i tyre rri pranë telefonit celular, 6 – 8 orë pranë telefonit celular kanë deklaruar 2 prindër kurse 0 – 2 orë vetëm një prind ka deklaruar që

fëmija i tij qëndron pranë telefonit celular, ndërsa pajisje e 2 që qëndrojnë me shumë këta fëmijë del të jetë televizioni me 0 – 2 orë janë deklaruar vetëm 5 prindër, me 3 – 5 një prind dhe 6 – 8 orë një prind, e përcjellë nga pajisjet e lojërave (Wii, PlayStation, etj) që është një koha prej 0 – 2 orë ku janë deklaruar 3 prindër.



Graf. 33. Sa shpesh përdoren pajisjet teknologjike nga fëmija juaj? (orë / ditë)


Për ta kuptuar se çfarë bën një fëmijë kur përdor pajisjet teknologjike pra cilat janë arsytet e përdorimit apo qëndrimit pranë tyre ne i pyetëm prindërit lidhur me aktivitetin e tyre pse ata i përdorin këto pajisje teknologjike, telefonin celular (smart) del të jetë pajisje me e pëlqyer ku shumica e prindërve janë përgjigjur që shumicën e aktiviteteve fëmijët e tyre e përdorin telefoni siç shihet edhe nga grafiku i mëposhtëm



Graf. 34. Arsytet e përdorimit të pajisjeve teknologjike

7.19 Kush operon me pajisjet teknologjike ndërsa ato janë në përdorim nga fëmija juaj


Për ta kuptuar se sa janë të pavarur fëmijët me sindromën Daun rreth përdorimit të pajisjeve elektronike i pyetëm prindërit e këtyre fëmijëve ku 40% e prindërve deklaruan që fëmija i tyre e përdor i vetëm pajisjen teknologjik pa pasur nevojë për asistim, 20% deklaruan që vetëm prindërit operojnë me pajisjet teknologjike dhe me 40% thanë që fëmija im dhe unë i përdorim së bashku pajisjet teknologjike.




Graf. 35. Operimi me pajisjet teknologjik nga ana e fëmijëve

Grafiku i mëposhtëm na tregon se a kanë fëmijët me sindromën Daun kufizime kohore në përdorimin e pajisjeve teknologjik. Për ta kuptuar këtë i pyetëm prindërit se nëse ata ua kufizojnë kohën e përdorimit të teknologjisë (fëmija me sindromën Daun dhe vëllezërit e motrat e tij ose të saj në zhvillim tipik), 80% apo 8 nga prindërit u deklaruan që po kanë kufizimi kohore kure me 20% apo 2 nga prindërit u deklaruan që fëmijët e tyre aktualisht kanë kufizime.

Për ta marrë sa më shumë informata lidhur me kufizimet që u bëjnë aktualisht fëmijëve me sindromën Daun si dhe vëllezërve dhe motrave të tyre në parashtruam edhe një pyetje për llojin e kufizimeve që vendosni në përdorimin e teknologjisë nga fëmijët e tyre, me kufizime kohore 4 nga prindërit thanë që i kufizojnë fëmijët me sindromën, në kufizime kohore kurse motrat ose vëllezërit e tyre vetëm një prindi deklaroi që kanë kufizime kohore, ndërsa sa i përket kufizime të përshtatshme për kohën prapë fëmijët me sindromën Daun janë më të kontrolluar se vëllezërit edhe motrat e tyre ku 4 nga prindërit deklaruan që vendosin këto kufizime dhe një prindi u deklarua se vendos kufizime specifike për fëmijët e tyre pa dallime.




Grafi. 36.A e kufizoni aktualisht përdorimin e teknologjisë së fëmijëve tuaj (fëmija me sindromën Daun dhe vëllezërit e motrat e tij ose të saj në zhvillim tipik)



Graf. 37.Kufizimet që bëhen nga ana e prindërve për fëmijët e tyre

7.20 Sa i përdorin fëmijët me sindromën Daun mediat sociale


Duke qenë të vetëdijshëm që po jetojmë në kohën e mediave sociale dhe për ta kuptuar se sa janë duke i përdorur fëmijët me sindromën Daun mediat social, ne i pyetëm prindërit e tyre ku 9 nga 10 prindërit apo 90% e tyre u deklaruan se fëmija i tyre me sindromën Daun përdor media sociale që shihet qartë që edhe fëmijët me sindromën Daun nuk janë keq në përdorimin e këtyre mediave sociale ndërsa vetëm 1 (një) prind u deklarua që fëmija i tij nuk i përdor mediat sociale.



Graf. 38. Përdorim i mediave sociale i fëmijëve me sindromën Daun

7.21 Mediat sociale më të preferuara që përdorin fëmijët me sindromën Daun

Grafiku i mëposhtëm tregon se cilat janë mediat më të preferua apo cilat media sociale që më së shpeshti i përdorin fëmijët me sindromën Daun (sipas prindërve) “prindërit kanë pasur mundësi të zgjedhin një e më shumë alternativa “, ku me 100% si media sociale më e preferuar del të jetë Instagrami, me 66.7 del të jetë Facebook ndërsa me 44.4 është Snapchat.



Graf. 39. Përdorimi i mediave sociale nga ana e fëmijëve me sindromën Daun

Përfundim

Në kuadër të kësaj teme të magjistraturës është punuar me përkushtim të madh për të arritur rezultate sa më reale për të kuptuar gjithëpërfshirjen e nxënësve me sindromën Daun në shkolla të cilët përdorin TIK-un, në shkollat e Skënderajt. Duke u bazuar në hulumtimin e bërë evidentohet dukshëm prirja se në komunën Skënderajt janë duke u bërë përpjekje serioze për gjithëpërfshirjen e fëmijëve me sindromën Daun në shkolla.

Zbatimi në praktikë i gjithëpërfshirjes kërkon shkallë më të lartë ndërgjegjësimi të të gjitha proceseve pjesëmarrëse, por edhe me gjerë, për të drejtat e fëmijëve me sindromën Daun për t'u arsimuar në shkolla të rregullta. Duke u bazuar në hulumtimin e bërë vërehet nevoja për ndryshime në sistemin arsimor, me qëllim krijimin e kushteve të nevojshme, për të mundësuar realizimin e arsimit gjithëpërfshirës, si dhe krijimin e një klime pozitive sociale, e pranuese në komunitetin e shkollës si dhe shoqërisë në përgjithësi.

Në këtë hulumtim janë përfshirë mësimdhënësit (vetëm nga komuna e Skënderajt) që janë duke punuar me nxënësit me sindromën Daun apo që kanë punuar me këtë grup të nxënësve, gjithashtu janë të përfshirë edhe mësimdhënësit që në klasën e tyre kanë të integruar nxënës me sindromën Daun. Hulumtimi ka ndodhur në të gjitha shkollat e Skënderajt ku janë identifikuar nxënës me sindromën Daun që ishin në tërësi (8) shkolla, po ashtu pjesë e hulumtimit kanë qenë edhe prindërit e fëmijëve me sindromën Daun. Nga të gjithë mësimdhënësit e anketuar del se 75% e tyre vetëm në disa raste e përdorin TIK-un për mësimdhënie, kurse 20% janë deklaruar që nuk e përdorin TIK-un fare për mësimdhënie me nxënësit me sindromën Daun kurse 5% janë deklaruar që TIK-un e përdorin për mësimdhënie.

Sipas rezultateve të hulumtimit kurrikula për nxënësit me nevojë të vecanta që në këtë kategori hynë edhe nxënësit me sindromën Daun nuk e parasheh përdorimin e TIK-ut ku me 80% apo 16 nga ta mësimdhënësit kanë deklaruar që nuk është e specifikuar (nuk e kanë hasur) që duhet të përdoret TIK-u me nxënësit me sindromën Daun, ndërsa me 20% kanë deklaruar se e parasheh që të ketë korrelacion (lidhje) me lëndën, TIK. Nga këtu shihet që edhe në kurrikula nuk është e specifikuar që të përdoret TIK-u me nxënësit me sindromën Daun.

Po ashtu sipas rezultateve të arritura mund të themi që nxënësit me sindromën Daun nuk përdorni TIK-un për mësimdhënie, sipas mësimdhënëseve që kanë marrë pjesë në këtë hulumtim janë deklaruar me 65% që kanë ngecje kurse në përdorimin e TIK-ut me 35% kanë deklaruar që fëmijët me sindromën

Daun nuk e përdorin TIK-un për mësimnxënie, gjithashtu 100% e prindërve janë deklaruar që fëmija i tyre nuk e përdori TIK-un për mësimnxënie. Nga kjo mund të themi që fëmijët me sindromën Daun nuk e përdornin TIK-un për mësimnxënie p.sh për detyra të ndryshme që i jepen nga mësimdhënësit.

Sipas rezultateve të arritura mund të themi që prindërit janë të përkushtuar dhe u kushtojnë vëmendje që fëmija i tyre të përdorë teknologjinë informative ku me 83% e prindërve kanë deklarua që fëmijët e tyre përdorin TIK-un me një kohë mesatar prej 4 deri në 7 ore në ditë, ku udhëzimet dirkete i marrin nga prindërit, vëllezërit ose motrat e këtyre fëmijëve, kurse koha e nisjes së përdorimit të një pajise teknologjike është mosha prej 18 mujashe deri në 4 vjeç, pothuajse është mosh kur të gjithë fëmijët veë nisin të përdorin pajisjen teknologjike. Pajiseja më e preferuar e fëmijëve me sindromën Daun del të jetë Telefoni (smart), kurse nga mediat sociale është Instagram. Arsytet e përdorimit të teknologjisë informative ishin për t'i kënaqur kuriozitetet e tyre, gjithashtu prindërit deklaruan se fëmijët e tyre (fëmija me sindromën Daun dhe vëllezërit e motrat e tij ose të saj në zhvillim tipik) kanë kufizime aktualisht në përdorimin e teknologjisë, kryesisht këto kufizime janë kohore.

Ky hulumtim ka pasur karakter lokal meqë është realizuar si studim i rastit vetëm në komunën e Skënderajt. Rezultatet e hulumtimit do të ishin shumë më bindëse në qoftë se hulumtimi do të ishte zgjeruar në tërë Republikën e Kosovës meqë rezultatet e tilla do të kishin karakter nacional dhe do të ishin përfshirë më shumë nxënës me sindromën Daun. Gjithashtu për të ardhmen mbetet që rezultatet e hulumtimit të krahasohen me rezultatet e shteteve përreth që të konstatohet gjendja sa më reale.

Përfundimisht mund të konkludohet se stadi ku në jemi aktualisht tregon që nxënësit me sindromën Daun janë të përfshirë në shkolla, por jo të gjithëpërfshirë. Sistemi ynë arsimor ende nuk i ofron të plota këto përshtatje, prandaj dhe gjithëpërfshirja e nxënësve me sindromën Daun në shkollat e rregullta mbetet në kufijtë e realizimit të pjesshëm.

Ky është një fakt, që kërkon më shumë vëmendje dhe më shumë angazhim, për të përmirësuar gjendjen dhe për t'iu krijuar kushte më të mira nxënësve me sindromën Daun, që të kenë mbështetje më të madhe nga komuna dhe institucionet tjera, në mënyrë që në të ardhmen ata të kontribuojnë me kapacitetet e tyre dhe të jenë pjesë e proceseve të rëndësishme. Përfitimet nga ky hulumtim janë që rezultatet t'iu vihen në shërbim institucioneve të Kosovës, si Ministrisë së Arsimit të Republikës së Kosovës dhe Drejtorisë së arsimit të komunës së Skënderajt në mënyrë që të merren masa për përmirësimin e kushteve për këtë kategori të nxënësve.

Rekomandimet

Duke parë me shumë vëmendje rezultatet e fituara nga studimi dhe duke analizuar në hollësi gjendjen e tanishme, u rekomandojmë institucioneve relevante që:

- MASHT-i të ketë një strategji dhe të përfshijë të gjithë fëmijët që janë anashkaluar në këtë ambient sfidues, që çdo nxënës dhe studenti t'u sigurohen kushtet e nevojshme për nxenie cilësore gjatë tërë jetës pa dallim përkatësie kombëtare, gjinie, religjioni apo aftësie, (e sidomos krijimi i mundësive për vazhdimin e shkollës së mesme ose ndonjë shkollë profesionale apo kurse të veçanta, për nxënësit me sindromën Daun të cilët e kanë mbaruar shkollën fillore dhe që nuk janë të inkuadruar në shkollat e mesme).
- Partneriteti me prindërit, pasi që prindërit në shkollën gjithëpërfshirëse konsiderohen si partnerë me të rëndësishëm, sepse, ata e njohin më së miri fëmijën e vet.
- Haritimi i kurrikules pse jo edhe një kurrikulë të veçantë ku parshihet që të nxënësit me sindromën Daun të kenë përfshirje të TIK-ut për mësimdhënie dhe për mësimnxenie
- Krijimi i ambienteve burimore në ndihmë të mësuesve, nxënësve, por nëse është e nevojshme edhe këshillimin e prindërve.
- Furnizimi me materialet didaktike dhe informuese mbi përdorimin e teknologjisë, për mësuesit dhe prindërit e nxënësve me sindromën Daun.
- Krijimi i kushteve më të mira për pjesëmarrjen e nxënësve me sindromën Daun në organizime të ndryshme kulturore, sportive qoftë brenda shkollës dhe jashtë saj, gjithashtu edhe bashkëpunim sa më të madh me bashkëmoshatarët e tyre pasi që këtu bëhet ndarja.
- Nevoja për punësimin e një numri më të madh të mësuesve mbështetës dhe asistentëve, ku e dimë që nxënësit me sindromën Daun kanë nevojë më shumë për ndihmë.

Zbatimi i mundshëm i këtyre rekomandimeve, besoj dhe shpresoj se do të ndikonte pozitivisht në ndryshimin e situatës dhe do të shërbente për të mirën e nxënësve me sindromën Daun dhe gjithëpërfshirjen e plotë të tyre nëpër shkolla dhe klasa të rregullat.

Bibliografia

- Agjencia e Statistikave të Kosovës, A. (2019). *Statistikat e Lindjeve*. Prishtinë: 2019.
- Bejtullahu, E. (2007). *Njohuri mbi aftësinë e kufizuar dhe rehabilitimi*. Prishtinë.
- Central Mississippi Down Syndrome Society. (2018). *New Parent Guide*. Mississippi .
- DOWN SYNDROME ASSOCIATION WEST MICHIGAN; DSAWM. (2010). Supporting the Student with Down Syndrome in Your Classroom. Në *Educator Manual*.
- Down Syndrome International. (a.d.). *Learning profile of a person with Down syndrome*. <https://www.ds-int.org/education>.
- Education, Governor's Council on Disabilities and Special. (a.d.). *Disability History Exhibit*. Alask: http://dhss.alaska.gov/gcdse/pages/history/html_content_main.aspx.
- Emrush Bejtullahu. (2007). Njohuri mbi aftësinë e kufizuar dhe rehabilitimi. Në E. Bejtullahu, *Njohuri mbi aftësinë e kufizuar dhe rehabilitimi* (f. 17). Prishtinë.
- Emrush, B. (2007). Njohuri mbi aftësinë e kufizuar dhe rehabilitimi. Prishtinë.
- Hughes, J. (2006). Inclusion in education - the benefits and keys to success. *Icam*, 2-3.
- Linda Salihu. (2009). *Vështirësitë në të nxënë*. Prishtinë.
- NDSS National Down Syndrom Society. (2017). Down Syndrom. <https://www.ndss.org/about-down-syndrome/down-syndrome/>.
- Pesamaa, T. (2003). Edukimi Special ne Kosovë. Në P. F. Kosovë, *Edukimi Special ne Kosovë*. Prishtinë.
- Pesamaa, T., & Zogu, A. (2003). Edukimi special në Kosovë. Në T. Pesamaa, & A. Zogu, *Edukimi special në Kosovë* (f. 7). Prishtinë.
- Publikimi vjetor i Statistikave të Arsimit ne Kosove për vitin shkollor 2019/2020, b. n. (2020). *Statistikat e arsimit në Kosovë 2019/2020*. Prishtinë: <https://www.masht-smia.net/publikime>.
- Sahliu, L. (2009). *Vështirësitë në të nxënë*. Prishtinë: 2009.
- Susan , S., & Stainback, W. (2000). Inclusion, Baltimore.
- Syndrome, D. (2015). *Myths & Truths*. <https://www.ndss.org/wp-content/uploads/2017/08/NDSS-Myths-and-Truths-2015.pdf>.
- Vygotsky, L. S. (a.d.). *Sociocultural Theory of Cognitive Development*. <https://educationaltechnology.net/lev-vygotsky-sociocultural-theory-of-cognitive-development/>.
- Wood, A. (2004). Supporting learning and development with ICT. *Down Syndrome Research and Practice*.

Zabeli, N. (2003). *Edukimi inkluziv*. Prishtinë .

Zabeli, N. (2001). *Nxënësit me nevoja të veçanta*. Prishtinë: 2001.

Zabeli, N. (2001). *Nxënësit me nevoja të veçanta*. Në N. Zabeli, *Nxënësit me nevoja të veçanta* (f. 13). Prishtinë.

Zabeli, N. (2003). *Edukimi inkluziv*. Prishtinë: 2003.

Zabeli, N. (2003). *Edukimi inkluziv*. Në N. Zabeli, *Edukimi inkluziv* (f. 30). Prishtinë: 2003.

Pjesa shtesë

Më lejoni që fillimisht t'ju falënderoj për pjesëmarrjen tuaj në këtë hulumtim. Hulumtimi quhet ***“Gjithëpërfshirja e nxënësve me sindromën Daun në shkolla duke përdorur TIK-un në procesin mësimor”***

Ky hulumtim është anonim dhe shërben vetëm për qëllime kërkimore. Përgjigjet tuaja nuk do të keqpërdoren në asnjë mënyrë dhe gjatë analizës së tyre do të ruhet privatësia juaj. Do të jemi mirënjohës nëse gjeni kohë të jeni pjesë e këtij hulumtimi.

Pyetësi për mësimdhënës

1. Në cilin nivel të procesit mësimor jeni duke punuar?

- a. Në arsimin parashkollor
- b. Në arsimin fillor
- c. Në arsimin e mesëm

2. Sa keni përvojë në mësimdhënie?

- a. 1-3
- b. 4-7
- c. 7-10
- d. Më shumë se 10 vite

3. Sa është me rëndësi të informoheni rreth sindromës Daun?

- a. Shumë
- b. Deri diku
- c. Pak
- d. Aspak

4. Sipas mendimit tuaj sa janë të rëndësishëm për ju dhe institucionin ku punoni, trajnimet rreth njohurive për nxënësit me sindromën Daun?

- a. Shumë të rëndësishme
- b. Të rëndësishme
- c. Pak të rëndësishme

5. Çka do të ndryshonit po të kishit mundësi në institucionin ku ju punoni për fëmijët me sindromën Daun?

- a. Përmirësimin e kushteve të punës
- b. Integrimin në shkolla të rregullta

- 6. Çfarë janë pritjet tuaja në përgjithësi për ndryshimet që mund të bëhen në dobi të fëmijëve me sindromën Daun për një të ardhme të afërt?**
- a. Implementimi i ligjeve për arsimin gjithëpërfshirës
 - b. Investimet në shëndetësi, në arsim dhe në çështje sociale
- 7. Cila është përvoja juaj kur keni hasur për herë të parë në një fëmijë me sindromën Daun?**
- a. Shumë e mirë
 - b. E mirë
 - c. E keqë
- 8. Në shkollën ku ju punon a janë të diskriminuar këta fëmijë në ambientet e shkollës suaj?**
- a. Jo, nuk janë të diskriminuar
 - b. Kam dëgjuar rastë që ka pasur diskriminim
 - c. Po, nga mësimdhënësit
 - d. Po, nga nxënësit
- 9. Si i pranojnë nxënësit e tjerë në klasë apo në shkollë nxënësit me sindromën Daun?**
- a. Shumë mirë
 - b. Mirë
 - c. Aspak mirë
- 10. A shoqërohen nxënësit e tjerë me nxënësit me sindromën Daun?**
- a. Po
 - b. Jo
- 11. A ka pasur rast në shkollën tuja që nxënësit me sindromën Daun kanë qenë agresivë apo kanë pasur konflikt me nxënësit e tjerë?**
- a. Po
 - b. Jo
- 12. Në cilat vështirësi keni hasur në mësimdhënie tek nxënësit me sindromën Daun?**
- a. Kanë nevojë për më shumë shpjegime
 - b. Nuk arrijnë të pranojnë informatën shumë shpejt
 - c. Kanë mungesë përqendrimi
- 13. A parasheh kurrikula që të përdoret TIK-u në procesin mësimor për fëmijët me sindromën Daun?**
- a. Po, e parasheh që të ketë korrelacion (lidhje) me lëndën, TIK
 - b. Nuk e parasheh
 - c. Nuk është e specifikuar (nuk e kam hasur)

- 14. Në shkollën ku punoni apo në klasën që punoni me nxënës me sindromën Daun a keni kabinet të TIK-ut?**
- a. Po, kemi kabinetin me të gjitha pajisjet
 - b. Po, kemi vetëm PC dhe projektor
 - c. Jo, nuk ka kushte në shkollë për kabinet
- 15. A e përdorni TIK-un për mësimdhënie me nxënës me sindromën Daun?**
- a. Po, rregullisht
 - b. Nganjëherë
 - c. Jo
- 16. Cilën prej pajisjeve teknologjike e përdorni?**
- a. TV
 - b. Kompjuter/projektor
 - c. SmartPhone
- 17. A keni vërejtur përqendrim kur nxënësit me sindromën Daun kanë përdorur TIK-un?**
- a. Po, ka pasur përqendrim dhe kureshtje
 - b. Jo, s'kam vërejtur
- 18. A keni njohuri që ka softuer special për nxënësit me sindromën Daun?**
- a. Po
 - b. Jo
- 19. Nëse jeni përgjigjur me *Po* cili është softueri që ju keni përdorur?**
1.
- 20. A përdorin TIK-un nxënësit me sindromën Daun për mësimnxënie?**
- a. Po, si bashkëmoshatarët e tyre
 - b. Kanë ngecje në përdorim të TIK-ut
 - c. Jo, nuk e përdorin
- 21. Cili është softuer që e përdorin nxënësit me sindromën Daun?**
- a. Word
 - b. Paint
 - c. Powerpoint
 - d. ²⁹Të tjera (Bajraktari, 2011)

Pyetësi për prindër

1. Sa vjeç është fëmija juaj?

- a. 1-5
- b. 6-10
- c. 11-14
- d. 15-17

2. A është i integruar në procesin mësimor fëmija juaj?

- a. Po, në arsimin parashkollor
- b. Po, në arsimin fillor
- c. Po në arsimin e mesëm
- d. Po, në qendra burimore, shkolla speciale
- e. Jo

3. A keni pasur vështirësi ta regjistroni në shkollë?

- a. Po, ka pasur hezitim nga personëli i shkollës
- b. Jo, nuk kemi pasur vështirësi

4. A ofrojnë shërbimet e komunës, qendrat familjare të shëndetit, shkollat, zyrtarët e arsimit informacion për nevojat dhe zhvillimin e fëmijës?

- a. Nuk ofrojnë sa kemi nevojë
- b. Po, ofrojnë

5. Në përgjithësi, në aspektin shoqëror dhe që ka të bëjë me rrethin tuaj familjar, a jeni të kënaqur me sjelljet e të tjerëve ndaj fëmijës suaj?

- a. Jo, nuk jam i/e kënaqur

²⁹ Sqarime,

Në disa prej pyetjeve të bëra në pyetësin për mësimdhënës jam bazuar në këtë hulumtim *“Raport mbi identifikimin e nevojave të komunitetit me sindromën Daun drejt përfshirjes në sistemin e arsimit që të mos jem subjektiv aq sa ma lejon ky raport është mundësuar me përkrahjen e Agjencisë së Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID) dhe Institutit për Komunitete të Qëndrueshme (ISC) përmes Programit për Fuqizimin e Shoqërisë Civile në Kosovë (K-CSSP). Opinione të shprehura në këtë publikim janë të autorit.”*

- b. Me rrethin familjar jam i/e kënaqur
- c. Nuk e di

6. Çka do të ndryshonit po të kishit mundësi në rrethin, lagjen tuaj për të mirën e fëmijëve me sindromën Daun?

- a. Vetëdijesimin kolektive
- b. Ambiente më të përshtatshme
- c. Respekt për fëmijët me sindromën Daun

7. Çfarë janë pritjet tuaja në përgjithësi për ndryshimet që mund të bëhen në dobi të fëmijës për një të ardhme të afërt?

- a. Nuk pres asgjë
- b. Shpresoj për ditë më të mira

8. Në cilën metodë e ndjek mësimin fëmija juaj?

- a. Në klasë të rregullt
- b. Në klasë të dedikuar për nxënësit me nevojë të veçanta
- c. Në shkollë speciale për nxënësit me sindromën Daun (qendra burimore)

9. A keni hasur në vështirësi për ta dërguar fëmijën në shkollë?

- a. Po, ka qenë shkolla larg dhe nuk ka pasur transport
- b. Po, sepse fëmija ka qenë i ngacmuar nga bashkëmoshatarët e tij
- c. Ka pasur hezitimi nga udhëheqja e shkollës që ta pranojnë
- d. Jo, nuk kam pasur vështirësi

2.

10. A i përdor fëmija juaj pajisjet teknologjike?

- a. Po
- b. Jo

11. Nëse nuk i përdor pajisjet teknologjike cila është arsyeja?

- a. Nuk kanë interesim për to, nuk i duken atraktive
- b. I prishin shumë shpejt dhe s'kemi mundësi t'i rregullojmë

12. Sa shpesh përdor fëmija juaj pajisje të teknologjisë 'Smart' (p.sh., telefona, tableta, kompjuterë) në ditë?

- a. 0-3 orë
- b. 4-7 orë

- c. 8-11 orë
- d. 12 e më shumë orë

13. Sa vjeç ishte fëmija juaj kur pajisjet e teknologjisë inteligjente u bënë pjesë e jetës së tij të përditshme?

- a. 18 muajshe-4 vjeç
- b. 5-8 vjeç
- c. 9-13 vjeç
- d. 14-17 vjeç
- e. Fëmija im nuk përdor teknologji jo të programueshme

14. Si mësoi fëmija juaj t'i përdorë pajisjet e teknologjisë inteligjente? (kontrolloni të gjitha ato që vlejné)

- a. Udhëzime të drejtpërdrejta nga prindërit ose vëllezërit e motrat
- b. Imiton
- c. Mëson në shkollë
- d. Fëmija im nuk e përdor këtë teknologji

15. Si e përdor fëmija juaj teknologjinë inteligjente? (kontrolloni të gjitha ato që vlejné)

- a. Koha e lirë / argëtimi
- b. Arsimi
- c. Komunikimi
- d. Duke kënaqur kuriozitetin e tij ose të saj

16. A e përdorni TIK-un për mësimnxënie, për detyra të ndryshme që i jepen nga mësimdhënësit?

- a. Po, rregullisht
- b. Jo

17. A keni njohur që ekzistojnë softuerë specialë për fëmijët me sindromëm Daun për mësimnxënie?

- a. Po
- b. Jo

18. Nëse jeni përgjigjur me PO cili është ai softuer që fëmija i juaj e përdor?

3.

19. Sa shpesh përdoren pajisjet e mëposhtme teknologjike nga fëmija juaj? (orë / ditë)

	0-2 orë	3-5 orë	6-8 orë	12-11 orë	12 orë e më shumë
Tëlfon celular	☐	☐	☐	☐	☐
Tablet (iPad, Microsoft Sipërfaqe, etj)	☐	☐	☐	☐	☐
iPod / pajisje muzikore	☐	☐	☐	☐	☐
Kompjuter (desktop ose laptop)	☐	☐	☐	☐	☐
Tëlevizioni	☐	☐	☐	☐	☐
Pajisja e lojërave (Wii, PlayStation, etj)	☐	☐	☐	☐	☐

20. Çfarë bën fëmija juaj duke përdorur pajisjet e mëposhtme? (kontrolloni të gjitha ato që vlejnë)

	Shikon filma, video dhe / ose shfaqje	Luan lojëra	Dëgjon muzikë	Shikon foto	Luan me një pajisje tjetër njëkohësisht	Ndërvepron me të tjerët
Tëlfon celular	☐	☐	☐	☐	☐	☐
Tablet (iPad, Microsoft Sipërfaqe, etj)	☐	☐	☐	☐	☐	☐
iPod / pajisje muzikore	☐	☐	☐	☐	☐	☐
Kompjuter (desktop ose laptop)	☐	☐	☐	☐	☐	☐
Tëlevizioni	☐	☐	☐	☐	☐	☐
Pajisja e lojrave (Wii, PlayStation, etj)	☐	☐	☐	☐	☐	☐

21. Kush operon me pajisjet teknologjike ndërsa ato janë në përdorim nga fëmija juaj?

- Unë (prindi) operoj me pajisjet teknologjike
- Fëmija im operon me pajisjet teknologjike
- Fëmija im dhe unë veprojmë së bashku me pajisjet teknologjike

22. A e kufizoni aktualisht përdorimin e teknologjisë së fëmijëve tuaj (fëmija me sindromën Daun dhe vëllezërit e motrat e tij ose të saj në zhvillim tipik)?

- a. Jo
- b. Po

23. Nëse jeni përgjigjur me Po në pyetjen e mëparshme, ju lutemi kontrolloni kutitë që zbatohen në çdo moshë për llojin e kufizimeve që vendosni në përdorimin e teknologjisë nga fëmijët tuaj.

	Moshat 5-8 vjec		Moshat 9-13 vjec		Moshat 14-17 vjec	
	Fëmijë me sindromën Daun	Zakonisht vëlla ose motër në zhvillim)	Fëmijë me sindromën Daun	Zakonisht vëlla ose motër në zhvillim)	Fëmijë me sindromën Daun	Zakonisht vëlla ose motër në zhvillim)
Kufizimet kohore	☐	☐	☐	☐	☐	☐
Kufizime të përshtatshme për moshën	☐	☐	☐	☐	☐	☐
Kufizime specifike të pajisjes p.sh., (celular pa shërbim)	☐	☐	☐	☐	☐	☐

24. A i përdor fëmija juaj mediat sociale?

- a. Jo
- b. Po

25. Nëse jeni përgjigjor me Po në pyetjen e mëparshme, cilat media sociale përdoren nga fëmija juaj? (kontrolloni të gjitha ato që vlejné)

- a. Facebook

- b. Twitter
- c. Instagram
- d. Snapchat

e. ³⁰Të tjera_____ (N.Fritz, 2017)

³⁰ Sgarime,

Në disa prej pyetjeve të bëra në pyetësin për prindër jam bazuar në këtë hulumtim **“The Impact of Technology on Individuals with Down Syndrome and Their Families”** Hulumtimi mbi Identifikimin e Ndikimi i teknologjisë tek individët me sindromën Daun dhe familjet e tyre, Programi në Çrregullimet e Komunikimit Teza e Nderimeve 2017. Ky hulumtim u mbështet nga dy universitete **“University of Arkansas Honors College Research Grants and an Honors College Travel Grant”**.

